FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 133

Tiranë – E mërkurë, 24 qershor 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 11, datë 4.6.2026	Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e masave administrative në rastet e shkeljeve në sektorin e peshkimit.....	12229
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 17, datë 15.6.2026	Për formatin dhe strukturën e planeve të prodhimit dhe marketingut	12232
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 646, datë 17.6.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë.....	12234
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 7.4.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 8, datë 4.2.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 19, datë 4.4.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-147, datë 30.1.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.....	12237
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50, datë 21.4.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1571 (186), datë 23.5.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.....	12251
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 22.4.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-749 (107), datë 26.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	12258

UDHËZIM
Nr. 11, datë 4.6.2026

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE NË RASTET E SHKELJEVE NË SEKTORIN E PESHKIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 128, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim miratimin e metodologjisë që siguron zbatimin e drejtë, të qartë dhe të unifikuar të masave administrative ndaj shkeljeve të dispozitave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", në sektorin e peshkimit, duke krijuar një sistem të drejtë dhe transparent për adresimin e kundërvajtjeve.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim zbatohet nga inspektorati që mbulon fushën e peshkimit në Republikën e Shqipërisë.

2. Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen për të gjitha subjektet fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitet në sektorin e peshkimit, transportit, tregtimit dhe përpunimit të produkteve të peshkimit.

Neni 3
Parimet

1. Metodologjia për përcaktimin e masave administrative bazohet në parimet si më poshtë: Përshtatshmëria: Përcaktimi i vlerës së masës administrative duhet të pasqyrojë seriozitetin e shkeljes dhe dëmin e shkaktuar.

2. Transparenca: Procesi i vendosjes së gjobave duhet të bazohet në kritere të qarta dhe të dokumentuara, për të shmangur subjektivizmin dhe keqkuptimet.

3. Përputhshmëria: Harmonizimi i praktikave midis inspektorëve për të siguruar një zbatim të barabartë të ligjit.

4. Qartësia: Metodologjia ndihmon në shmangien e paqartësive midis subjekteve dhe inspektorëve, duke krijuar besim në sistemin e drejtësisë administrative.

Neni 4
Kriteret për përcaktimin e masës administrative

Përcaktimi i masës administrative të parashikuar në këtë udhëzim është vendosur mbi kriteret:

a) natyrën dhe rëndësinë e shkeljes;

b) shkallën e dëmit ekonomik dhe mjedisor të shkaktuar;

c) sasinë e zënieve ose të produkteve objekt shkeljeje;

ç) përsëritjen e shkeljes nga i njëjti subjekt;

d) shkallën e bashkëpunimit të subjektit gjatë kontrollit;

dh) faktin nëse shkelja është kryer në zona të mbrojtura ose mbi specie të mbrojtura;

e) përfitimin ekonomik të realizuar ose të synuar nga shkelja;

ë) çdo rrethanë tjetër rënduese ose lehtësuese të konstatuar gjatë procedurës administrative.

Neni 5
Rastet e moszbatimit të metodologjisë

1. Metodologjia e përcaktuar në këtë udhëzim zbatohet vetëm për ato masa administrative për të cilat ligji parashikon interval vlerash ose lë hapësirë vlerësimi për organin administrativ.

2. Për shkeljet administrative të parashikuara në nenin 128, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, për të cilat është përcaktuar masë administrative me vlerë fikse, zbatohet drejtpërdrejt masa e përcaktuar në ligj, pa aplikuar kriteret e metodologjisë së këtij udhëzimi.

Neni 6
Detajimi i masave administrative

Detajimi i masave administrative sipas parashikimeve të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", bëhet si më poshtë:

1. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "ç", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Peshkimi i peshqve të paarrirë:

a) Për peshqit e zënë të paarrirë nga 10–20% e totalit të zënieve: gjoba 100,000 lekë;

b) Për peshqit e zënë të paarrirë nga 20–30% e totalit të zënieve: gjoba 300,000 lekë;

c) Për peshqit e zënë të paarrirë nga 30–40% e totalit të zënieve: gjoba 700,000 lekë;

d) Për peshqit e zënë të paarrirë mbi 40% e totalit të zënieve: gjoba 1,000,000 lekë.

2. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "dh", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Për shkeljet që lidhen me hedhjen apo shfrytëzimin e rërës ose zhavorrit, shkarkimin apo zhvendosjen e ujërave ose të materialeve të tjera ndotëse, si dhe ndërhyrjen, prishjen apo shkatërrimin e mjedisit në zonat e mbrojtura ujore:

a) Nëse shkelja ka shkaktuar dëmtim të lehtë mjedisor dhe pa pasoja të konsiderueshme në habitatin ujor: gjoba 400,000 lekë;

b) Nëse shkelja ka sjellë ndotje të konsiderueshme, dëmtim të habitatit, cenim të biodiversitetit ose depozitim materialesh ndotëse në sipërfaqe të konsiderueshme: gjoba 1,000,000 lekë;

c) Nëse shkelja ka shkaktuar dëmtim të rëndë ose të pakthyeshëm të habitatit ujor, ndotje masive, shkatërrim të ekosistemit: gjoba është 1,500,000 lekë. Nëse shkelja është në mënyrë të përsëritur: gjoba 2,000,000 lekë.

3. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "e", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Ndërtimi i strukturave në kundërshtim me legjislacionin në zonat e mbrojtura ujore:

a) Ndërtimi i strukturave të përkohshme ose lehtësisht të çmontueshme në tokë ose në ujë, pa autorizimin përkatës: gjoba 600,000 lekë;

b) Ndërtimi i strukturave fikse që cenojnë habitatin natyror, aksesin ose funksionimin e zonës së mbrojtur ujore: gjoba 1,500,000 lekë;

c) Ndërtimi i porteve, platformave, argjinaturave, strukturave industriale ose çdo ndërtim tjetër që shkakton dëmtim të rëndë të ekosistemit ujor ose ndryshim të karakteristikave natyrore të zonës së mbrojtur: gjoba 3,000,000 lekë.

4. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "f", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Peshkimi në kundërshtim me urdhrin për ndalimin e peshkimit:

a) Sasi peshqish nën 5 kg: gjoba minimale 200,000 lekë;

b) Sasi peshqish 5 deri në 10 kg: gjoba nga 200,000 deri në 500,000 lekë;

c) Sasi peshqish 10–15 kg: gjoba 500,000 deri në 700,000 lekë;

d) Sasi peshqish mbi 15 kg: gjoba maksimale 1,000,000 lekë;

5. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "g", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Peshkimi i peshqve të zënë në kundërshtim me urdhrin për ndalimin e peshkimit:

a) Sasi peshqish nën 2 kg: gjoba minimale 100,000 lekë;

b) Sasi peshqish 2 deri në 5 kg: gjoba nga 250,000 deri në 350,000 lekë;

c) Sasi peshqish mbi 5 kg: gjoba maksimale 500,000 lekë.

6. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "h", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Përdorimi i substancave dhe mjeteve të ndaluara për peshkim:

a) Përdorimi i substancave toksike, narkotike dhe gërryese, pajisjeve që gjenerojnë shkarkime elektrike, eksplozivëve dhe substancave të tjera: gjoba 2,500,000 lekë;

b) Përdorimi i mjeteve për mbledhjen e koralit të kuq dhe llojeve të tjera të koraleve dhe organizmave të ngjashëm: gjoba 1,500,000 lekë;

c) Përdorimi i rrjetave fundore mbledhëse me madhësi hapjeje më të vogël se 40 mm për peshkarexha: gjoba 500,000 lekë.

7. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "m", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Aktivitet peshkimi nga anije të huaja:

a) Anijet e huaja me fuqi motorrike nën 224 kw: gjoba 3,000,000 lekë;

b) Anijet e huaja me fuqi motorrike nga 225–500 kw: gjoba deri në 4,000,000 lekë;

c) Anijet e huaja me fuqi motorrike mbi 500 kw: gjoba maksimale 5,000,000 lekë.

8. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "n", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Aktivitet

peshkimi nga anije të huaja në zonën ekskluzive ekonomike të Shqipërisë pa leje:

a) Anijet e huaja me fuqi motorrike nën 224 kw: gjoba 200,000 lekë;

b) Anijet e huaja me fuqi motorrike nga 225–500 kw: gjoba deri në 400,000 lekë;

c) Anijet e huaja me fuqi motorrike mbi 500 kw: gjoba maksimale 600,000 lekë.

9. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "nj", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Zënia e specieve të mbrojtura

a) Korani i lumit (*Salmo letnica* lumi): gjoba 100,000 lekë;

b) Koralet (*Corallium spp.*): gjoba 1,000,000 lekë;

c) Trofta (*Salmo trutta magrostigma*, *Salmo marmoratus*): gjoba 300,000 lekë;

d) Blinjtë (*Acipenser sturio*, *Acipenser naccarii*): gjoba 1,000,000 lekë;

e) Peshkaqenët dhe rajat: gjoba 1,000,000 lekë;

f) Lopa e detit (*Mobula*): gjoba 700,000 lekë;

g) Gurëshpuesi (*Lithophaga lithophaga*): gjoba 1,000,000 lekë;

h) Sfungenjtë (*Spongidae*): gjoba 1,000,000 lekë;

i) Gjitarët e detit (balenat, delfinët, fokat): gjoba 1,000,000 lekë;

j) Breshkat e detit (*Carretta carretta, Chelonia mydas, Dermochelys coreacea*): gjoba 1,000,000 lekë;

k) Breshkat e ujit të ëmbël (*Emys orbicularis, Mauremys caspica*): gjoba 500,000 lekë;

l) Zogjtë detarë: gjoba 500,000 lekë;

m) Molusqe bivalvore (*Pinna nobilis, Pholas dactylus*): gjoba 700,000 lekë;

n) Iriq deti (*Centrostephanus longispinus*): gjoba 500,000 lekë.

10. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "o", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Mbajtja dhe tregtimi i pendëve të peshkaqenëve:

a) Sasia e pendëve nën 2 kg: gjoba 100,000 lekë;

b) Sasia 3–5 kg: gjoba 300,000 lekë;

c) Sasia mbi 5 kg: gjoba 500,000 lekë.

11. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "q", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Përdorimi i eksplozivëve dhe substancave të tjera për peshkim:

a) Sasi peshku nën 2 kg: gjoba 100,000 lekë;

b) Sasi peshku 2–5 kg: gjoba 300,000 lekë;

c) Sasi peshku mbi 5 kg: gjoba 500,000 lekë.

12. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "xh", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Mosdeklarimi i zënieve të peshkimit:

a) Mosdeklarimi për herë të parë: gjoba 5,000 lekë;

b) Mosdeklarimi i përsëritur: gjoba 10,000 lekë.

13. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "y", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Peshkimi mbi normat e lejuara:

a) Sasi deri 20 kg: gjoba 50,000 lekë;

b) Sasi 20–50 kg: gjoba deri në 80,000 lekë;

c) Sasi mbi 50 kg: gjoba deri në 100,000 lekë.

14. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "z", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Mosinstalimi i sistemit të monitorimit në anije:

a) Mosdeklarimi për herë të parë: gjoba 50,000 lekë;

b) Mosdeklarimi i përsëritur: gjoba 100,000 lekë.

15. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "zh", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Transbordimi i zënieve në vende të pamiratuara:

a) Shkelja për herë të parë: gjoba 10,000 lekë;

b) Shkelja e përsëritur: gjoba 50,000 lekë.

16. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "dd", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Mosparaqitja e certifikatës së origjinës së produkteve peshkore:

a) Shkelja për herë të parë: gjoba 50,000 lekë;

b) Shkelja e përsëritur: gjoba 100,000 lekë.

17. Shkelja e përcaktuar në shkronjën "ee", të nenit 128, të ligjit nr. 64/2012 – Përdorimi i veglave jo të autorizuara:

a) Kurthe: gjoba 100,000 lekë;

b) Vegla stacionare: gjoba 300,000 lekë;

c) Vegla jo stacionare: gjoba 500,000 lekë.

Neni 7

Dispozita e fundit

1. Ngarkohet Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

UDHËZIM[1]
Nr. 17, datë 15.6.2026

PËR FORMATIN DHE STRUKTURËN E PLANEVE TË PRODHIMIT DHE MARKETINGUT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 19, pika 2, të nenit 21, të vendimit nr. 372, datë 20.5.2026, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës, dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut",

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim përcakton formatin, strukturën dhe përmbajtjen e planeve të prodhimit dhe marketingut që paraqiten pranë Ministrisë nga organizatat e prodhuesve në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për organizatat e prodhuesve në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës, të njohura sipas legjislacionit në fuqi.

KREU II
STRUKTURA E PLANIT TË PRODHIMIT DHE MARKETINGUT

Neni 3
Përmbajtja e përgjithshme e planit

Planet e prodhimit dhe marketingut përmbajnë informacionin e detajuar të strukturuar sipas elementeve të përcaktuara në shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.

Neni 4
Informacioni i përgjithshëm mbi organizatën e prodhuesve

1. Planet përmbajnë informacion të përgjithshëm mbi organizatën e prodhuesve, si vijon:
a) emrin e plotë të organizatës;
b) llojin e organizatës (peshkim ose akuakulturë);
c) kodin e identifikimit (NIPT);
ç) vendndodhjen dhe zonën e kompetencës;
d) numrin e anëtarëve.
2. Planet përmbajnë të dhëna mbi xhiron dhe vëllimin e zënieve ose prodhimit, të detajuara sipas specieve, sipas përshkrimit në shtojcën I.
3. Xhiroja llogaritet sipas përcaktimeve të parashikuara në shtojcën I.

KREU III
PROGRAMI I PRODHIMIT DHE STRATEGJIA E MARKETINGUT

Neni 5
Hyrja dhe koherenca e planit

1. Planet përmbajnë një hyrje që shpjegon koherencën ndërmjet masave të parashikuara dhe objektivave të planit.
2. Hyrja bazohet në një vlerësim të aseteve, mundësive, kërcënimeve dhe dobësive të organizatës së prodhuesve.
3. Ky prezantim përcakton qartë lidhjen ndërmjet programit të prodhimit dhe strategjisë së marketingut.

Neni 6
Programi i prodhimit

1. Programi i prodhimit përbëhet nga një plan orientues furnizimi gjatë vitit, i bazuar në tendencat sezonale të tregut.
2. Programi i prodhimit merr parasysh:
a) planifikimin e aktiviteteve të prodhimit;

[1] Ky udhëzim përafron plotësisht Rekomandimin e Komisionit Evropian, datë 3 mars 2014, *"Mbi hartimin dhe zbatimin e planeve të prodhimit dhe marketingut",* në zbatim të Rregullores (BE) nr. 1379/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, *"Për organizimin e përbashkët të tregjeve të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës".*

b) koordinimin me prodhues të tjerë.

3. Për organizatat e prodhuesve në peshkim, programi i prodhimit përfshin, gjithashtu:

a) menaxhimin e të drejtave të peshkimit dhe aksesit ndërmjet anëtarëve;

b) zbatimin dhe menaxhimin e detyrimit për shkarkimin e të gjitha zënieve.

4. Për organizatat e prodhuesve në akuakulturë, programi i prodhimit përfshin zhvillimin e praktikave të qëndrueshme të akuakulturës.

Neni 7
Strategjia e marketingut

1. Strategjia e marketingut përshkruan mënyrën se si organizata e prodhuesve siguron përputhshmërinë e ofertës me kërkesat e tregut.

2. Strategjia e marketingut merr parasysh, në veçanti:

a) kërkesat e tregut;

b) tregjet e reja dhe mundësitë tregtare;

c) dialogun dhe koordinimin me operatorët e zinxhirit të furnizimit.

KREU IV
MASAT PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE

Neni 8
Masat për organizatat e prodhuesve në peshkim

Planet e prodhimit dhe marketingut për organizatat e prodhuesve në peshkim përfshijnë masa që lidhen me objektivat e përcaktuar në nenin 2, të vendimit nr. 372, datë 20.5.2026, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës, dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut", sipas përmbajtjes së detajuar në shtojcën I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 9
Masat për organizatat e prodhuesve në akuakulturë

Planet e prodhimit dhe marketingut për organizatat e prodhuesve në akuakulturë përfshijnë masa që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës dhe tregut, sipas përmbajtjes së detajuar në shtojcën I.

Neni 10
Masat për përshtatjen e ofertës

Planet përfshijnë masa për përshtatjen e ofertës për specie të caktuara, sipas përmbajtjes së detajuar në shtojcën I.

KREU V
KONTROLLI, SHPENZIMET DHE ZBATIMI

Neni 11
Masat e kontrollit dhe rregullat e brendshme

Organizatat e prodhuesve përcaktojnë në planet e tyre masa të brendshme kontrolli dhe rregulla për zbatimin e planeve, në përputhje me vendimin nr. 372, datë 20.5.2026, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës, dhe për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planeve të prodhimit dhe marketingut".

Neni 12
Plani financiar dhe shpenzimet

1. Planet përmbajnë një plan financiar që detajon shpenzimet dhe burimet financiare të pritshme.

2. Shpenzimet ndahen, në:

a) aktivitetet e zotëruesit të projektit;

b) aktivitetet e menaxhimit të projektit.

Neni 13
Afatet e zbatimit

Planet përmbajnë një kalendar të zbatimit të masave dhe shpenzimeve përkatëse, sipas rastit edhe në këste vjetore.

Neni 14
Treguesit

Planet përcaktojnë tregues të produkteve dhe të rezultateve për monitorimin e zbatimit të tyre, sipas përmbajtjes së detajuar në shtojcën I.

KREU VI
RAPORTIMI DHE DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 15
Raporti vjetor

1. Organizatat e prodhuesve paraqesin raport vjetor mbi zbatimin e planeve.
2. Raporti vjetor përmban treguesit e produkteve dhe të rezultateve sipas shtojcës I.

Neni 16
Dispozitat e fundit

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, struktura përgjegjëse për inspektimin mbi peshkimin dhe organizatat e prodhuesve në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 646, datë 17.6.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E KROACISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	**Ndarja administrative e nivelit 2**	**Ndarja administrative e nivelit 3**
Osjecko-Baranjska	Đurđenovac*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Kneževi Vinogradi*	
Osjecko-Baranjska	Magadenovac*	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Osjecko-Baranjska	Viljevo*	
Viroviticko-Podravska	**Zdenci***	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata

shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë përgatitur nga mishi i freskët që plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 640, datë 15.6.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Kroacisë", shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 47, datë 7.4.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 7.4.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (J) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Jasin Kala (alias Avdyli), përfaqësuar nga avokati Baftjar Rusi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Dritan Prençi dhe Vladimir Mara.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 8, datë 4.2.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 19, datë 4.4.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-147, datë 30.1.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 27, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), nenet 2, 20, 21, 27, 28, 31, 32, 33, 34, 38, 39, 42, 43, 43/b, 47, 49, pika 3, shkronja "e", 51, shkronja "a", 71/a, 71/b, 71/c, pikat 1, 2, 3, 72, 76, pikat 1 dhe 6, 81 dhe 86, pika 3, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Jasin Kala (alias Avdyli) (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

i. Procesi i parë gjyqësor

1. Me vendimin nr. 40, datë 26.2.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës kërkuesi është deklaruar fajtor për veprën penale "Vrasja me paramendim e mbetur në tentativë", të parashikuar nga nenet 78, 22 e 25 të Kodit Penal (*KP*), duke u dënuar përfundimisht me 15 vjet burgim.

ii. Procesi i dytë gjyqësor

2. Me vendimin e Gjykatës së Vogheres, Itali kërkuesi është dënuar për veprat penale "Vrasja" dhe "Shfrytëzimi i prostitucionit". Ky vendim është njohur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 11-2015-196, datë 21.1.2015 dhe në bashkim të dënimeve është dënuar me 27 vjet burg për kryerjen e veprave penale "Vrasja", "Vdekja ose plagosja për shkak të një krimi tjetër", "Zjarrvënia", "Dhuna ose kërcënimi i një funksionari publik", "Dëmtime Trupore", "Kanosja", "Armëmbajtja pa leje" dhe "Shfrytëzimi i Prostitucionit". Ndër të tjera, në këtë vendim është disponuar edhe konvertimi i këtij dënimi në masën 25 vjet burgim, me qëllim transferimin e kërkuesit për të vuajtur në Shqipëri pjesën e pavuajtur të dënimit, si dhe njohja e dënimit plotësues, detyrimi për të mos hyrë në territorin e shtetit italian për gjithë jetën. Ky vendim është ekzekutuar me urdhrin e datës 3.11.2015. Ndërsa, me vendimin nr. 520, datë 31.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kërkuesi është liruar me kusht, duke e vënë në provë për një periudhë prej 18 muajsh.

iii. Procesi i tretë gjyqësor

3. Në datën 31.1.2020, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 1 me fuqinë e ligjit "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës

kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike" *(akti normativ nr. 1/2020)*. Ky akt, i cili ka pasur efekt të përkohshëm deri në datën 31.12.2020, është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 18/2020, datë 5.3.2020. Në zbatim të tij, në përfundim të verifikimeve të kryera nga struktura e posaçme Operacioni Forca e Ligjit *(OFL)* mbi të dhënat e marra nga një sërë institucionesh shtetërore dhe bankat, në datën 16.9.2021, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në gjykatë kërkesën për vendosjen e masës së sekuestros për pasuritë e kërkuesit.

4. Me vendimin nr. 151, datë 1.10.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) ka vendosur sekuestrimin e pasurive të luajtshme (tre automjete) dhe pasurive të paluajtshme: nr. 29/236, volumi 59, faqe 245, zona kadastrale 8512, e llojit "truall", me sipërfaqe totale 362 m² dhe sipërfaqe 193 m² ndërtesë, e regjistruar në pronësi të shtetases F. A. (nëna e kërkuesit); "arë +truall", me sipërfaqe 856 m², sipërfaqe trualli 300 m², ndërtesë 147 m², Lagjja Popullore, Shijak; "truall", me sipërfaqe 6000 m², i ndodhur në Gjepalaj, Shijak, në pronësi të disa personave të tjerë. Ky vendim është lënë në fuqi në të gjitha shkallët e gjykimit.

5. Në vijim, me vendimin nr. 63, datë 20.12.2022, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të pasurive të vendosura me vendimin nr. 151, datë 1.10.2021, të saj. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga kërkuesi dhe Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(GJKKO-ja e Apelit)*, me vendimin nr. 67, datë 2.5.2023, ka vendosur mospranimin e tij.

6. Ky vendim rezulton të jetë kundërshtuar në Gjykatën e Lartë nga kërkuesi dhe, nga të dhënat e faqes zyrtare të kësaj gjykate, rezulton se me vendimin nr. 00-2023-1332, datë 31.7.2023, është vendosur rrëzimi i kërkesës së kërkuesit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, ndërsa me vendimin nr. 00-2025-1605, datë 21.10.2025, mospranimi i rekursit të tij.

iv. Procesi i katërt gjyqësor

7. Mbi bazën e informacionit të Komisariatit të Policisë Kavajë, në datën 28.12.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. 339/2016 për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve" në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a, paragrafi 2, i KP-së dhe në datën 16.5.2017, ka vendosur ndarjen e akteve të procedimit penal nr. 339/2016 në procedimin penal nr. 339/1 në ngarkim të kërkuesit.

8. Po kështu, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (*Prokuroria e Durrësit*) ka regjistruar në ngarkim të kërkuesit procedimin penal nr. 2159/2017 për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 i KP-së, për shkak të dyshimeve se kryente aktivitet kriminal të kundërligjshëm me lëndë narkotike në bashkëpunim me shtetasin O. J., fakt ky i parashikuar si vepra penale "Trafikimi i lëndëve narkotike". Me shpalljen e moskompetencës lëndore të kësaj prokurorie, aktet janë regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda me nr. 38/2019, procedimi penal dhe për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 i KP-së. Në kuadër të veprimeve hetimore, në datën 16.5.2019, kjo prokurori ka regjistruar si emra të personave në hetim atë të kërkuesit dhe vëllait të tij, Sh. A. dhe ky procedim rezulton të jetë bashkuar më vonë me procedimin penal nr. 339 të vitit 2016.

9. Për procedimin penal nr. 339/1, me urdhrin e datës 14.8.2018, është regjistruar emri i kërkuesit edhe për kryerjen e veprave penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" dhe "Grupi i strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 283 dhe 333/a të KP-së, pasi nga hetimi ka rezultuar se gjatë këtij aktiviteti kriminal i pandehuri H. S., duke qenë në rolin e organizatorit, ka bashkëpunuar edhe me kërkuesin e shtetasin D. Ll. Nga veprimet e vëzhgimit dhe përgjimit, si dhe aktet e tjera të administruara, ka rezultuar se lënda narkotike e llojeve të ndryshme, pasi trafikohej nga vende të ndryshme, shpërndahej më pas nëpërmjet lidhjeve të këtyre subjekteve në tregun e brendshëm. Gjatë kësaj kohe janë kryer edhe një sërë përgjimesh telefonike të kërkuesit me bashkëpunëtorët e tij, të pandehurin O. J. dhe persona të tjerë të paidentifikuar, për të cilët hetimet vazhdojnë në çështjen e ndarë. Në përfundim të hetimeve, prokurori ka kërkuar kalimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit dhe të pandehurve të tjerë, e cila është pranuar me vendimin nr. 11, datë 8.5.2020, të gjyqtarit të seancës paraprake.

10. Në përfundim të gjykimit të çështjes, me vendimin nr. 8, datë 4.2.2022 (*vendimi nr. 8/2022*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 287, shkronja "b", i KP-së, e dënimin e tij me 7 vjet burgim, ndërsa e ka deklaruar atë të pafajshëm për akuzën e kryerjes së veprave penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 283, 333/a, paragrafi 2 dhe 334, pika 1, të KP-së, me arsyetimin se nuk provohet se fakti ekziston. Po kështu, në aplikim të nenit 36 të KP-së, gjykata ka vendosur edhe konfiskimin e kalimin në favor të shtetit të pasurisë "University Lounge Bar", me numër pasurie 29/64, të ndodhur në Currila, Durrës.

11. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, pasi ka bërë një analizë të elementeve të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, të parashikuar nga neni 287 i KP-së, ka vlerësuar se kërkuesi e ka kryer këtë vepër penale. Sipas asaj gjykate, kërkuesi është marrë më herët me ushtrimin e aktiviteteve të paligjshme që kanë sjellë përfitime, pasi ka qenë i dënuar nga Gjykata e Vogheres, Itali edhe për veprën penale të "Shfrytëzimi i prostitucionit", vendim dënimi i njohur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 11-2015-196, datë 21.1.2015. Po kështu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, nga veprimet hetimore të kryera ka rezultuar se kërkuesi së bashku me vëllain e tij kanë krijuar pasuri të paluajtshme, si rezultat i veprimtarisë kriminale dhe nuk rezulton që këto pasuri të justifikohen me burime të ligjshme. Ndërkohë, lidhur me përgjegjësinë penale për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal", "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", pasi ka bërë një analizë juridike të elementeve të anës objektiv dhe subjektive të veprës penale, ka vlerësuar se kërkuesi J. K. dhe shtetasi D. Ll. janë vëzhguar në mënyrë të fshehtë vazhdimisht dhe nga vëzhgimet përveç takimeve nuk rezulton i provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm fakti penal për të cilin akuzohen. Rezulton se këta shtetas janë përgjuar e vëzhguar për një kohë të gjatë për shkak të dyshimit se merreshin me shpërndarjen e lëndës narkotike e megjithatë nuk janë kontrolluar në asnjë moment në kuadër të këtij dyshimi *(shih vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, faqe 36*). Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim Prokuroria e Posaçme dhe kërkuesi.

12. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 19, datë 4.4.2023, ka lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë në pjesën që e ka deklaruar kërkuesin fajtor për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", në bashkëpunim, dhe që ka konfiskuar e kaluar në favor të shtetit pasurinë "University Lounge Bar", ndërsa ka ndryshuar vendimin e asaj gjykate, duke e deklaruar kërkuesin fajtor edhe për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 283, paragrafi 1, në lidhje me nenet 28, paragrafi 4 dhe 334, paragrafi 1, të KP-së, dhe "Grupi i strukturuar kriminal", të parashikuar nga neni 333/a, paragrafi i dytë, i KP-së. Në aplikim të nenit 55 të KP-së, gjykata e ka dënuar kërkuesin me 12 vjet burgim. Në arsyetimin e saj ajo gjykatë, fillimisht, është ndalur në vlerësimin e mosriçeljes së shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e apelit, sipas nenit 427, pika 4, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), pasi provat mbi të cilat bazohej fajësia ishin provat me shkresë dhe jo ato të gjalla. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka rezultuar se detyrimi konventor i vendit tonë për respektimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor në gjykimin në gjykatën e apelit lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes prej saj, kur duhet të vendosë për herë të parë për dënimin e të pandehurit, ka të bëjë vetëm me provat verbale, të cilat kanë qenë përcaktuese në deklarimin e tij të pafajshëm. Ky përfundim mbështetet edhe në jurisprudencën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2022-657 (175), datë 21.6.2022. Po kështu, ka arsyetuar ajo gjykatë, ky vlerësim mbështetet edhe nga Gjykata e Kasacionit të Italisë në interpretimin e dispozitës 603 simotër në KPP-në italiane (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqet 18–22*).

13. Më tej, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se fajësia e kërkuesit për veprat penale, për të cilat është akuzuar, provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ajo

gjykatë ka evidentuar se në funksion të hetimit që lidhej me veprimtarinë kriminale të prodhimit, shitjes dhe trafikimit të lëndës narkotike, janë vënë në përgjim telefonik telefonat e kërkuesit dhe të bashkëpandehurve të tjerë nga ku ka rezultuar se ndërmjet tyre zhvilloheshin biseda të shumta dhe nëpërmjet vëzhgimeve dhe përgjimeve ambientale evidentoheshin takime të shpeshta ndërmjet tyre. Sipas gjykatës së apelit, në analizë të kontekstit të bisedave të zhvilluara ndërmjet tyre kuptohet që flitet për lëndë narkotike, kjo në një gjuhë të koduar "mjaltë". Po kështu, sipas procesverbaleve "Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve" të kryera në datat 30.1.2018, 28.2.2018, 22.3.2018 dhe 14.9.2018, ka rezultuar se ndërmjet kërkuesit, por edhe të pandehurve të tjerë, D. Ll., O. J., dhe personave të tjerë pjesëmarrës në veprimtari kriminale ka jo vetëm takime të shpeshta, çka tregon për lidhjet dhe njohjen e afërt që ata kanë me njëri-tjetrin, por këto takime janë në koherencë të plotë për qëllimin e vërtetë të veprimtarisë kriminale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Gjithashtu, fakti që nga kontrolli i banesës të të bashkëpandehurit të gjykuar më vete O. J., më 21.10.2018, është gjetur një sasi lënde narkotike prej 0.4 gramë e llojit "kokainë", përbën një indicie të rëndësishme që, e lidhur me të dhënat që përfitohen nga provat e tjera, konfirmon se në bisedat e zhvilluara ndërmjet të pandehurve të tjerë i referohen pikërisht lëndës narkotike të llojit "kokainë". GJKKO-ja e Apelit ka evidentuar se një fakt tjetër është edhe ai që kërkuesi njoftohej për kontrollet e policisë në zonën ku vepronte dhe njoftimi i fundit është bërë në datën 13.9.2018, pak kohë përpara ndërhyrjes dhe ekzekutimit të masës së sigurimit "Arresti në burg" për secilin nga anëtarët e grupit, rrethanë kjo që merr vlerë pasi nuk i është sekuestruar lëndë narkotike, ndërsa shtetasit O. J. sasia e përmendur më lart (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqe 35*). Ndaj këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs, duke kërkuar prishjen e tij dhe pushimin e çështjes.

14. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-147, datë 30.1.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke argumentuar se rekursi i kërkuesit nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së dhe se nuk kishte shkelje të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatës së apelit. Ndër të tjera, ky kolegj ka vlerësuar se GJKKO-ja e Apelit nuk është bazuar në një provë të vetme për të arritur në përfundimin se fajësia e kërkuesit provohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Sipas atij kolegji, të dhënat e përftuara nga përgjimet telefonike janë ballafaquar dhe vlerësuar në harmoni me prova të tjera, sikundër vëzhgimet ambientale, si dhe prova materiale lëndë narkotike e llojit "kokainë", e gjetur dhe sekuestruar gjatë kontrollit të banesës të të bashkëpandehurit të gjykuar më vete, O. J. Analiza e provave të verifikuara në këtë proces penal është jo thjesht një citim i tyre, por analizë cilësore në raport me njëra-tjetrën dhe në përputhje me kërkesat e ligjit penal, material e procedural (*shih vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, paragrafi 23*).

15. Në datën 22.5.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 26.5.2025. Në datën 22.7.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa në datën 28.7.2025, kjo e fundit ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e:

16.1 *Së drejtës për proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspekt të:

16.1.1 *Së drejtës për t'u vënë në dijeni menjëherë për akuzën, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur,* për shkak se: i. nuk është njoftuar asnjëherë për akuzën; ii. kërkesat e tij, të parashtruara si para organit të akuzës në mbyllje të hetimeve paraprake, ashtu edhe përpara gjyqtarit të hetimeve paraprake, për t'u pyetur në përputhje me parashikimet e nenit 327, pika 4, të KPP-së, nuk janë marrë parasysh; iii. është deklaruar fajtor mbi akte absolutisht të pavlefshme, në cenim të parimit të *ligjshmërisë në marrjen e provave*; iv. Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore.

16.1.2 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* pasi, pa kërkesë të organit të akuzës, mbi të njëjtat prova që gjykata e shkallës së parë i ka çmuar si akte që nuk provojnë fajësinë e tij për veprat penale të parashikuara nga nenet 283, paragrafi 1, 28, pika 4, 25, 333/a dhe 334, pika 1, të

KP-së, GJKKO-ja e Apelit e ka deklaruar fajtor në kundërshtim me nenin 427, pika 4, të KPP-së, pa riçelur hetimin gjyqësor dhe pa e përsëritur atë, bazuar në akte absolutisht të pavlefshme, në cenim edhe të *parimit të barazisë së armëve*.

16.1.3 *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi arsyetimet e vendimeve të gjykatave të posaçme, në pjesën që e kanë gjetur fajtor dhe e kanë dënuar, janë të palogjikshme, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka shqyrtuar shkaqet e rekursit të tij. Vendimi i këtij Kolegji është jologjik dhe kontradiktor, pasi, pavarësisht pretendimeve të ngritura për shkeljet e kryera, ai ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk ka shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

16.2 *Parimit të sigurisë juridike* në drejtim të *gjësë së gjykuar*, pasi, me vendimin nr. 265, datë 17.7.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka rrëzuar kërkesën e prokurorit për lejimin e përgjimit të telefonit të tij. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2018-1477, datë 19.7.2018, me arsyetimin se nuk rezultojnë të dhëna se kërkuesi dhe shtetasi Sh.A. janë të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283 ose 283/a i KP-së.

16.3 *Parimit ne bis in idem*, të parashikuar nga neni 34 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë vendosur konfiskimin e pasurisë "University Lounge Bar", me numër pasurie 29/64, të ndodhur në Currila, Durrës, ndërkohë që: i. të ardhurat e burimet e krijimit të kësaj pasurie kanë qenë objekt hetimi prej kohësh nga ajo gjykatë; ii. kjo pasuri ishte konfiskuar më parë me vendimin nr. 63, datë 20.12.2022, të GJKKO-së së Shkallës së Parë.

16.4 *Parimit të mosrëndimit të pozitës të të pandehurit (reformatio in peius),* pasi GJKKO-ja e Apelit e ka deklaruar fajtor edhe për veprat penale të parashikuara nga nenet 283, paragrafi 1, 28, pika 4, 25, 333/a dhe 334, pika 1, të KP-së, ndonëse prokurori nuk ka kërkuar riçeljen e hetimit.

16.5 *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi ai është deklaruar fajtor bazuar kryesisht në përgjime dhe vlerësime hipotetike, pa u shoqëruar këto me prova materiale, kapje në flagrancë ose elemente konkrete që provojnë mbajtjen ose shitjen e lëndëve narkotike, ndonëse ka qenë për një periudhë të gjatë nën përgjim. Gjatë hetimit nuk ka rezultuar asnjë provë që të vërtetojë akuzat. Akuza është paraqitur në gjykim pa prova, pa hetim të përfunduar dhe veprime të kërkuara nga mbrojtja dhe, me të drejtë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka deklaruar të pafajshëm për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve. Kërkuesi ka biseda me shtetasin O. J., si kushëri i bashkëshortes, por nuk ka asnjë përgjim e transkriptim që bën fjalë për transport, shitje ose shpërndarje lëndësh narkotike. Ndërkohë që me shtetasin D. Ll. ai është shok fëmijërie, janë rritur bashkë dhe banojnë shumë afër njëri-tjetrit. Megjithatë, GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë pa çelur hetimin gjyqësor dhe pa e përsëritur atë. Ajo ka vlerësuar se bashkëpunimi rezultonte nga bisedat dhe përgjimet e komunikimeve të tij me shtetasit O. J dhe D. Ll, si dhe nga fakti që gjatë kontrollit të banesës shtetasit O.J. i janë gjetur 0.4 gramë kokainë, edhe pse ky shtetas është përdorues. Po kështu, vetëm fakti se kërkuesi dhe i vëllai disponojnë pasuri nuk mund të shërbejë për përfundimin se ka elemente të veprës penale të trafikimit të narkotikëve, për sa kohë nuk është provuar origjina kriminale e këtyre pasurive.

17. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme*, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se:

17.1 Pretendimi për cenimin *e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesit brenda shkaqeve të rekursit.

17.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar* është i pabazuar, pasi vendimet gjyqësore që kërkuesi referon kanë për objekt "lejimin e përgjimit" dhe nuk janë të lidhura e nuk kanë efekt në vendimet gjyqësore objekt ankimi.

17.3 Pretendimi për cenimin e *parimit të mosrëndimit të pozitës të të pandehurit (reformatio in peius*) është i pabazuar, pasi riçelja e shqyrtimit gjyqësor në apel është kompetencë diskrecionale e gjykatës së apelit dhe përsëritja e shqyrtimit gjyqësor vlerësohet nga kjo gjykatë rast pas rasti, në ushtrim të pushtetit të saj si gjykatë fakti dhe ligji. Në rastin konkret, GJKKO-ja e Apelit nuk ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor, pasi e ka deklaruar fajtor kërkuesin mbi bazën e të gjitha elementeve që vinin nga burimet e provave me shkresë (dokumentare) dhe jo ato të gjalla, sikurse deklarimet e të pandehurve ose dëshmitarëve.

17.4 Pretendimi për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* është i pabazuar, pasi fajësia e kërkuesit është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ajo nuk është bazuar në një provë të vetme, por në një tërësi provash, si përgjimet telefonike, vëzhgimet ambientale, si dhe prova materiale e llojit "kokainë", e gjetur dhe sekuestruar gjatë kontrollit të bashkëpandehurit O. J.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

18. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

19. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f", të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës "i", të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 30.1.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë, në datën 22.5.2025, pra brenda afatit 4-mujor.

20. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor (në aspekt të *së drejtës për t'u vënë në dijeni menjëherë me akuzën, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, parimit të sigurisë juridike* në drejtim të *gjësë së gjykuar, parimit ne bis in idem, parimit të mosrëndimit të pozitës të të pandehurit,* si dhe *parimit të prezumimit të pafajësisë*), të garantuar respektivisht nga nenet 42, 4, 34 dhe 30 të Kushtetutës.

21. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t'u vënë në dijeni menjëherë për akuzën, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur,* duke parashtruar katër argumente: i. nuk është njoftuar asnjëherë për akuzën; ii. kërkesat e tij, të parashtruara si përpara organit të akuzës në mbyllje të hetimeve paraprake, ashtu edhe përpara gjyqtarit të hetimeve paraprake, për t'u pyetur në përputhje me parashikimet e nenit 327, pika 4, të KPP-së, nuk janë marrë parasysh; iii. është deklaruar fajtor mbi akte absolutisht të pavlefshme dhe mbi të njëjtat prova që GJKKO-ja e Shkallës së Parë i ka konsideruar si akte që nuk provojnë fajësinë, në cenim të parimit të *ligjshmërisë në marrjen e provave*; iv. Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka prapësuar lidhur me këtë pretendim.

22. Sipas nenit 31, shkronja "a", të Kushtetutës, gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë, ndër të tjera, të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij, ndërsa sipas nenit 33 të Kushtetutës kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet. Këto dispozita ofrojnë garancitë minimale me qëllim bërjen efektive të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në procesin penal. Referuar dispozitave procedurale penale, që zbërthejnë dispozitat kushtetuese, neni 327 parashikon se prokurori njofton për përfundimin e hetimeve paraprake të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, dhe i pandehuri njoftohet gjithashtu, se ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklarime ose të kërkojë që të merret në pyetje. Kur i pandehuri kërkon të pyetet, prokurori është i detyruar të procedojë me pyetjen e tij (pika 4).

23. E drejta e mbrojtjes në procesin penal, si një nga elementet thelbësore të procesit të rregullt, përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë shpjegime. Në jurisprudencën kushtetuese janë përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërdrejt mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit *(shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 37, datë 30.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Për respektimin e këtyre parimeve gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet, sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit ose mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes etj. (*shih vendimin nr.18, datë 2.4.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vëren se për sa i takon argumentit të parë të kërkuesit se nuk është njoftuar për akuzën në ngarkim të tij, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për efekt të gjykimit kushtetues rezulton se atij në datën 31.12.2019, me vendimin për marrjen e personit si i pandehur dhe njoftimin e akuzës, i janë komunikuar akuzat në ngarkim të tij. Në vendimin nr. 11, datë 8.5.2020, GJKKO-ja e Shkallës së Parë (gjyqtari i hetimit paraprak) ka evidentuar se me vendimin për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës, datë 31.12.2019, të pandehurve iu janë komunikuar të njëjtat akuza të përmendura edhe në aktin për përfundimin e hetimeve. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit, me argumentin se nuk është njoftuar për akuzën, është haptazi i pabazuar.

25. Po kështu, lidhur me argumentin e dytë të kërkuesit për mosmarrjen parasysh të kërkesës së tij për t'u pyetur gjatë fazës së hetimeve paraprake, sipas pikës 4 të nenit 327 të KPP-së, nga materialet e dosjes gjyqësore Gjykata vëren se sipas vendimit nr. 11, datë 8.5.2020 të GJKKO-së së Shkallës së Parë (gjyqtari i hetimit paraprak), referuar procesverbaleve të datave 3.1.2020, 6.1.2020 dhe 7.1.2020, kërkuesi është pyetur në cilësinë e të pandehurit, ndërsa ka refuzuar që të japë shpjegime, duke përfituar nga e drejta që i ka njohur neni 166 i KPP-së (*shih vendimin nr. 11, datë 8.5.2020, të GJKKO-së së Shkallës së Parë, faqe 13*). Në këtë situatë, në kushtet kur gjatë fazës së hetimit paraprak kërkuesit i është dhënë mundësia për t'u pyetur, ndërsa nuk ka dhënë pëlqimin për këtë, Gjykata vlerëson se argumenti i tij lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar gjatë kësaj faze është haptazi i pabazuar.

26. Për sa i përket argumentit të tretë të kërkuesit, se është deklaruar fajtor mbi akte absolutisht të pavlefshme, në cenim të parimit të *ligjshmërisë në marrjen e provave*, Gjykata vëren se kërkuesi në ankimin kushtetues individual nuk ka identifikuar ose specifikuar se cilat janë provat për të cilat ai pretendon se nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se gjykimi kushtetues është i natyrës argumentuese, që do të thotë se i takon kërkuesit të parashtrojë argumentet faktike mbi të cilat mbështet pretendimet e tij *(shih vendimet nr. 57, datë 25.7.2017; nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 45, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese).* Po kështu, pretendimi se të njëjtat prova janë vlerësuar ndryshe nga gjykatat e faktit lidhet me mjaftueshmërinë dhe çmuarjen e tyre për deklarimin fajtor, por nuk nënkupton, në vetvete, se ato janë marrë në mënyrë të paligjshme ose se përbëjnë akte absolutisht të pavlefshme. Ky argument lidhet me mënyrën e vlerësimit dhe mjaftueshmërinë e provave për deklarimin fajtor, çështje që shqyrtohet në vijim në kuadër të pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, vetëm fakti se kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të ligjshmërisë në marrjen e provave nuk mjafton nga pikëpamja kushtetuese për të vënë në dyshim respektimin e garancive për proces të rregullt ligjor, ndaj argumenti i tij në drejtim të pretendimit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes për këtë shkak është haptazi i pabazuar.

27. Gjykata vëren gjithashtu se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar,* për shkak të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Sipas nenit 433/a të KPP-së, shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së

Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomë këshillimi. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se nëse Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore *(shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Gjykata vë në dukje se shqyrtimi paraprak i rekursit të kërkuesit është bërë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, sipas formës së gjykimit të përcaktuar nga ligji procedural penal. Për rrjedhojë, vetëm fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm, në këndvështrimin kushtetues, për të vënë në dyshim procesin e zhvilluar në atë gjykatë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, si rezultat i shqyrtimit paraprak të rekursit të tij përmes kësaj forme gjykimi, është haptazi i pabazuar.

28. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të sigurisë juridike* në drejtim të *gjësë së gjykuar*, me argumentin se gjykata e rrethit dhe ajo e apelit kanë vendosur rrëzimin e kërkesës së organit të akuzës për lejimin e përgjimit të komunikimeve telefonike të tij dhe të të pandehurit tjetër Sh. A., për shkak se nuk kishte të dhëna për përfshirjen e tyre në këtë veprimtari kriminale. Në këtë situatë, sipas tij, gjykatat duhet t'i kishin marrë parasysh këto vendime. Për këtë pretendim, Prokuroria e Posaçme ka prapësuar se ai është i pabazuar, pasi, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, vendimet gjyqësore në fjalë kanë të bëjnë me lejimin e përgjimit dhe nuk lidhen e as kanë efekt me vendimet gjyqësore objekt ankimi.

29. Për sa i takon këtij pretendimi, nga materialet e dosjes gjyqësore, Gjykata konstaton se me vendimin nr. 10-2018-1477, datë 19.7.2018, Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. 265, datë 17.7.2018, me të cilin është rrëzuar kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për vleftësimin si të ligjshëm të vendimit të datës 16.7.2018, për përgjimin dhe lejimin e vazhdimit të përgjimit për një periudhë 15-ditore, nga data 16.7.2018 deri në datën 31.7.2018. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të këtyre vendimmarrjeve është marrë në shqyrtim edhe nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka vlerësuar se vendimet në fjalë kanë të bëjnë me vendimmarrje të gjyqtarit të hetimit paraprak. Ky i fundit, mbi bazën e provave të paraqitura deri në atë moment nga organi i akuzës, ka vlerësuar se nuk plotësoheshin kushtet për lejimin e përgjimit, sipas kërkesave të nenit 221 të KPP-së. Sipas GJKKO-së së Apelit, vendimmarrjet për moslejimin e përgjimit nuk ishin detyruese dhe vendimtare për gjykatën që gjykonte themelin e çështjes, në kushtet që fajësia e kërkuesit ishte mbështetur në një tërësi provash të grumbulluara në kuadër të hetimit, të cilat jo vetëm që nuk kishin qenë objekt vlerësimi nga ana Gjykata e Apelit Durrës, por edhe çmuarja e tyre ishte atribut ekskluziv i gjykatës që shqyrtonte themelin e çështjes (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqe 53*). Qëndrimi i GJKKO-së së Apelit është vlerësuar i drejtë në thelb nga Gjykata e Lartë.

30. Për sa më sipër, Gjykata evidenton se nga vendimet e gjykatave të posaçme nuk rezulton që transkriptet e përgjimeve për periudhën për të cilën është rrëzuar kërkesa për vleftësimin ose vazhdimin e përgjimit të jenë përdorur si provë për deklarimin fajtor të kërkuesit. Pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim kanë marrë përgjigje edhe nga gjykatat e zakonshme, arsyetimi i të cilave nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues. Po kështu, Gjykata vëren se vendimi për lejimin e përgjimit merret nga gjyqtari i hetimit paraprak në zbatim të nenit 222 të KPP-së, në të cilin parashikohet se, me kërkesën e prokurorit, gjykata autorizon përgjimin me vendim të arsyetuar, kur ai është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur në ngarkim të personit ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se ka kryer një vepër penale. Ky vendim nuk përbën vendim përfundimtar për themelin e akuzës penale ose për fajësinë e personit, pra nuk përbën "gjë të gjykuar" për qëllime të procesit penal. Në këtë situatë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar është haptazi i pabazuar.

31. Gjykata vëren gjithashtu se kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit *ne bis in dem*, duke parashtruar se gjykatat kanë vendosur konfiskimin e pasurisë "University Lounge Bar", me numër

pasurie 29/64, të ndodhur në Currila, Durrës, **e cila, sipas akteve, rezulton e regjistruar në emër të nënës së tij,** ndërkohë që: i. të ardhurat dhe burimet e krijimit të kësaj pasurie kanë qenë objekt i një procedimi pasuror pranë gjykatave të posaçme; ii. kjo pasuri është konfiskuar më parë me vendimin nr. 63, datë 20.12.2022, të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka prapësuar lidhur me këtë pretendim.

32. Sipas nenit 34 të Kushtetutës askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se *ratio* i kësaj dispozite kushtetuese është sanksionimi i parimit "*të mosgjykimit dhe dënimit dy herë për të njëjtën vepër penale*" (*ne bis in idem*) dhe parimit të "*gjësë së gjykuar*" (*res judicata*), të cilat vijnë si garanci në kuadër të mbrojtjes të të drejtave të individit në fushën penale. Ky parim parashikon se askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim përfundimtar, pra për të njëjtin fakt që përbën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kriteri "e njëjta vepër" i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor që formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilën personi është dënuar ose liruar. Në këtë kuptim, Gjykata ka pohuar se nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm (*shih vendimet nr. 47, datë 5.10.2023; nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 33, datë 22.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Gjykata vëren se argumentet e kërkuesit lidhur me pretendimin për cenimin e parimit *ne bis in idem* i referohen pasurisë "University Lounge Bar", me numër pasurie 29/64, të ndodhur në Currila, Durrës, për të cilën ai pretendon se është konfiskuar më parë në kuadër të procedimit pasuror, ndërkohë që nga rrethanat e çështjes rezulton se në atë procedim pasuror është sekuestruar fillimisht, me vendimin nr. 151, datë 1.10.2021, të GJKKO-së së Shkallës së Parë, pasuria nr. 29/236, volumi 59, faqe 245, ZK 8512, e llojit "truall", me sipërfaqe totale 362 m² dhe sipërfaqe ndërtese 193 m², e cila më pas është konfiskuar dhe ka kaluar në pronësi të shtetit me vendimin nr. 63, datë 20.12.2022, të GJKKO-së së Shkallës së Parë, për të cilin kontrolli gjyqësor vijon në Gjykatën e Lartë.

34. Gjykata vëren, gjithashtu, se ky pretendim i kërkuesit është shqyrtuar dhe analizuar edhe nga gjykatat e zakonshme. Në lidhje me të, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se regjistrimi i një procedimi pasuror në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" (*ligji nr. 10192/2009*) ose aktit normativ nr. 1/2020, nuk ndalon sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë në zbatim të nenit 36 të KP-së. Pra, sekuestrimi ose konfiskimi i pasurisë, si rrjedhojë e regjistrimit të një procedimi pasuror *in rem,* në bazë të ligjit nr. 10192/2009 ose aktit normativ nr. 1/2020, nuk e pengon gjykatën të procedojë gjatë gjykimit penal *in personam*. Në këtë situatë, pretendimet e mbrojtësit të kërkuesit se e njëjta pasuri është objekt hetimi dhe gjykimi pranë së njëjtës gjykatë, me kërkesë të organit të prokurorisë, në kuadër të procedurave të tjera gjyqësore, nuk përbëjnë pengesë ligjore për të proceduar me konfiskimin e kësaj pasurie në kuadër të këtij procedimi penal, pasi ekziston një dallim i qartë ndërmjet konfiskimit gjatë procedimit penal *in personam*, pra procedimit të bazuar në dënim, ku konfiskimi jepet si masë pas dënimit penal të personit për kryerjen e një krimi, dhe konfiskimit *in rem* mbi pasurinë *(shih vendimin nr. 19, datë 4.4.2023, të GJKKO-së së Apelit, faqe 51–53)*. Qëndrimi i GJKKO-së së Apelit është vlerësuar i drejtë në thelb edhe nga Gjykata e Lartë.

35. Në analizë të vendimmarrjeve të këtyre gjykatave, Gjykata evidenton se konfiskimi i pasurisë në bazë të aktit normativ nr. 1/2020 është një proces i cili nuk zhvillohet në fushën penale, pra nuk synon të vërtetojë një fakt penal, sepse rregullat e gjykimit në këtë rast janë ato të parashikuara në KPC, ndërsa pasojat e këtij gjykimi janë të natyrës civile, sepse lidhen me pasurinë (*shih vendimin nr. 4, datë 21.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata vëren, po ashtu, se pasuria për të cilën kërkuesi ngre pretendimin rezulton *de jure* e regjistruar në emër të nënës së tij, çka mund të ngrinte çështje edhe në drejtim të legjitimimit të tij *ratione personae* për të kundërshtuar, në emër të vet, pasojat pasurore të vendosura ndaj një pasurie që formalisht i përket një personi të tretë. Megjithatë, duke pasur parasysh se konfiskimi i kësaj pasurie është vendosur në kuadër të procesit penal

të zhvilluar ndaj kërkuesit dhe se pretendimi i tij lidhet me zbatimin e parimit *ne bis in idem* në këtë proces, Gjykata çmon se nuk është e nevojshme të ndalet përfundimisht në çështjen e legjitimimit *ratione personae,* pasi, edhe nëse do të pranohej se kërkuesi ka një interes të mjaftueshëm për ngritjen e këtij pretendimi, ai gjithsesi nuk rezulton i bazuar *ratione materiae.* Në këtë kuptim, duke mbajtur në konsideratë se konfiskimi i pasurisë në rastin konkret, në bazë të nenit 36 të KP-së, është rrjedhojë e procesit penal në ngarkim të kërkuesit dhe, si i tillë, u është nënshtruar rregullave e kufizimeve të përcaktuara në KPP, ndërsa procedura e konfiskimit parandalues të pasurisë është zhvilluar mbi bazën e dispozitave të KPC-së, në përputhje me natyrën *in rem* të këtij kufizimi pasuror, Gjykata çmon se, edhe nëse do të pranohej pretendimi i kërkuesit se pasuria e konfiskuar në procesin penal përkon ose lidhet me pasurinë objekt procedimi pasuror, vetëm kjo rrethanë nuk është e mjaftueshme për të aktivizuar garancinë e nenit 34 të Kushtetutës, pasi procedimi pasuror dhe procedimi penal kanë natyrë, objekt dhe pasoja të ndryshme juridike, ku i pari zhvillohet *in rem* dhe synon kufizimin/konfiskimin parandalues të pasurisë, ndërsa i dyti zhvillohet *in personam* dhe lidhet me përgjegjësinë penale të personit, si dhe me pasojat që rrjedhin nga dënimi penal. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit *ne bis in idem,* është haptazi i pabazuar.

36. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të mosrëndimit të pozitës të të pandehurit,* me pretendimin se GJKKO-ja e Apelit ka rënduar pozitën e tij, duke e deklaruar fajtor edhe për veprat penale të parashikuara nga nenet 283 dhe 333/a të KP-së, ndonëse prokurori nuk ka kërkuar riçeljen e shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 427, pika 4, të KPP-së.

37. Parimi i mosrëndimit të pozitës të të pandehurit (*reformatio in peius)* parashikohet në legjislacionin procedural penal dhe konkretisht në nenin 425, pika 3, të KPP-së. Sipas këtij neni, kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë ose t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se një gjykatë më e lartë nuk mund të caktojë një masë dënimi më të rëndë nga ai i vendimit të apeluar bazuar vetëm në ankimin e të pandehurit. Sipas Gjykatës, zbatimi i parimit *reformatio in peius* është një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës. Ekzistenca e këtij parimi u jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre. Nga ky këndvështrim, mosrespektimi i parimit të mosrëndimit të pozitës të të pandehurit do të përbënte njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së *(shih vendimet nr. 46, datë 11.6.2024; nr. 45, datë 3.7.2017; nr.15, datë 22.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese).*

38. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, Gjykata vëren se në rastin konkret, nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara, rezulton se krahas kërkuesit ndaj vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, në pjesën që e kishte deklaruar atë të pafajshëm për veprat penale që lidhen me narkotikët dhe grupin e strukturuar kriminal, ka ushtruar ankim edhe prokurori, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit të asaj gjykate dhe deklarimin fajtor të kërkuesit edhe për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe "Grupi i strukturuar kriminal", me argumentin se ishte dhënë në zbatim të gabuar të ligjit material penal.

39. Në këtë situatë, Gjykata çmon se, ndryshe nga sa kërkuesi pretendon, nuk ndodhemi në kushtet e zbatimit të parimit *reformatio in peius*, për sa kohë që ankimi është ushtruar jo vetëm nga kërkuesi, por edhe nga prokurori. Fakti nëse prokurori ka kërkuar apo jo riçeljen ose përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 427, pika 4, të KPP-së, nuk e ndryshon këtë përfundim, pasi ky argument lidhet me mënyrën e shqyrtimit të çështjes në apel dhe jo me ndalimin e rëndimit të pozitës të të pandehurit kur apelues është vetëm i pandehuri. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e këtij parimi, në mënyrën sesi është parashtruar prej tij, është haptazi i pabazuar.

40. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* dhe të *parimit të barazisë së armëve*, duke parashtruar se pa kërkesë të organit të akuzës, mbi të njëjtat prova që gjykata e shkallës së parë i ka çmuar si akte që nuk provojnë fajësinë e tij për veprat penale të

parashikuara nga nenet 283, paragrafi 1, 28, pika 4, 25, 333/a dhe 334, pika 1, të KP-së, GJKKO-ja e Apelit e ka deklaruar fajtor, pa riçelur hetimin gjyqësor, në kundërshtim me nenin 427, pika 4, të KPP-së. Po ashtu, sipas kërkuesit, vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar edhe *parimin e prezumimit të pafajësisë* dhe *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* lidhur me arsyetimin në drejtim të provueshmërisë së fajësisë së tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Gjykata, duke pasur parasysh thelbin e këtyre pretendimeve, çmon që ato të analizohen në vijim së bashku në drejtim të *parimit të prezumimit të pafajësisë*.

41. Për sa më sipër, në vijim Gjykata do të shqyrtojë bazueshmërinë në themel të pretendimeve të kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

42. Kërkuesi ka pretenduar se pa kërkesë të organit të akuzës, mbi të njëjtat prova që gjykata e shkallës së parë i ka çmuar si akte që nuk provojnë fajësinë e tij për veprat penale të parashikuara nga nenet 283, paragrafi 1, 28, pika 4, 25, 333/a paragrafi 2 dhe 334, pika 1, të KP-së, GJKKO-ja e Apelit e ka deklaruar fajtor në kundërshtim me nenin 427, pika 4, të KPP-së, pa riçelur hetimin gjyqësor dhe pa e përsëritur atë. Sipas kërkuesit, ai është deklaruar fajtor bazuar kryesisht në përgjime dhe vlerësime hipotetike, pa u shoqëruar këto me prova materiale, kapje në flagrancë ose elemente konkrete që provojnë mbajtjen ose shitjen e lëndëve narkotike, ndonëse ka qenë për një periudhë të gjatë nën përgjim. Po sipas kërkuesit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë me të drejtë e ka deklaruar të pafajshëm për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, pasi ai ka biseda me shtetasin O. J., si kushëri i bashkëshortes, por nuk ka asnjë përgjim e transkriptim që bën fjalë për transport, shitje ose shpërndarje lëndësh narkotike. Ndërkohë që me shtetasin D. Ll. ai është shok fëmijërie, janë rritur bashkë dhe banojnë shumë afër njëri-tjetrit. Megjithatë, GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë, duke vlerësuar se bashkëpunimi rezultonte nga bisedat dhe përgjimet e komunikimeve të tij me shtetasit O. J dhe D. LL, si dhe nga fakti që gjatë kontrollit të banesës shtetasit O. J. i janë gjetur 0.4 gramë kokainë, edhe pse ky shtetas është përdorues.

43. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, e ka prapësuar si të pabazuar këtë pretendim, me argumentin se riçelja e shqyrtimit gjyqësor në apel është kompetencë diskrecionale e gjykatës së apelit dhe përsëritja e shqyrtimit gjyqësor vlerësohet nga kjo gjykatë rast pas rasti, në ushtrim të pushtetit të saj si gjykatë fakti dhe ligji. Po sipas Prokurorisë së Posaçme, në rastin konkret GJKKO-ja e Apelit nuk e ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor, pasi e ka deklaruar fajtor kërkuesin mbi bazën e provave me shkresë (dokumentare) dhe jo ato të gjalla. Sipas këtij subjekti, fajësia e kërkuesit është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, ajo nuk është bazuar në një provë të vetme, por në një tërësi provash, si të dhënat e përftuara nga përgjimet telefonike, vëzhgimet ambientale, si dhe prova materiale e llojit "kokainë", e gjetur dhe sekuestruar gjatë kontrollit të bashkëpandehurit O. J.

44. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kushtetues ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 4 të KPP-së, i cili përcakton, gjithashtu, se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Në jurisprudencën kushtetuese parimi i prezumimit të pafajësisë është elaboruar në drejtim të faktit se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Gjykatat duhet të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 68, datë 14.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Sipas këtij parimi asnjë dënim ose masë që barazohet me të nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 8, datë*

20.2.2024; nr. 12, datë 24.8.2018, të Gjykatës Kushtetuese).

45. Lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur, gjithashtu, se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si dukshëm të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 7.3.2024; nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 33, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Në parantezë të analizës së këtij argumenti, Gjykata vëren se vlerësimi i provave është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 42, datë 7.7.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur vlerësimi i provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka cenuar parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë çështja i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, gjatë verifikimit nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesit gjykatat e posaçme kanë respektuar garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

49. Konkretisht, *sipas njërit qëndrim*,[2] pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar. Në mbështetje të këtij pretendimi, kërkuesi ka parashtruar tre argumente: i. gjykata e apelit e deklaroi fajtor mbi të njëjtat prova mbi të cilat gjykata e shkallës së parë e kishte deklaruar të pafajshëm, pa përsëritur hetimin gjyqësor; ii. rezultatet e përgjimeve ishin të pamjaftueshme për të provuar fajësinë e tij, pasi nuk ekziston asnjë bisedë e përgjuar që lidhet drejtpërdrejt me transportin, shitjen ose shpërndarjen e lëndëve narkotike; iii. gjetja e 0.4 gramëve kokainë në banesën e O. J., i cili rezulton përdorues i lëndëve narkotike, nuk mjafton për të provuar bashkëpunimin e tij në veprimtarinë kriminale. Nisur nga këto argumente dhe në dritën e standardeve kushtetuese që burojnë nga parimi i prezumimit të pafajësisë (*shih paragrafin 44 të vendimit*), për vlerësimin e pretendimit duhet verifikuar nëse GJKKO-ja e Apelit ka zhvilluar një shqyrtim të plotë të çështjes dhe nëse ka përcaktuar në mënyrë të qartë e të saktë faktet relevante për përgjegjësinë penale të kërkuesit.

50. Lidhur me shqyrtimin e plotë të çështjes së kërkuesit, konstatohet se gjykata e apelit ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme përse nuk ishte e nevojshme përsëritja e hetimit gjyqësor. Sipas saj, provat vendimtare mbi të cilat ishte mbështetur vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë për pafajësinë e kërkuesit ishin prova dokumentare, përmbajtja e të cilave nuk ndryshon gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndryshe nga provat verbale. Në mbështetje të këtij përfundimi, Gjykata e apelit ka interpretuar nenin 427, pika 4, të KPP-së në dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykatës së Kasacionit të Italisë dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqet 18-22*). Në të njëjtën linjë, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se pretendimi i kërkuesit për shkelje procedurale për shkak të mospërsëritjes së shqyrtimit gjyqësor nuk qëndronte, duke theksuar se riçelja e shqyrtimit gjyqësor në apel është kompetencë diskrecionale e gjykatës së apelit dhe vlerësohet rast pas rasti. Sipas saj, në rrethanat konkrete, mospërsëritja e shqyrtimit gjyqësor nuk

[2] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini dhe Asim Vokshi.

përbënte shkelje procedurale, pasi provat përcaktuese për akuzat e ngritura ishin dokumentare dhe jo prova të gjalla, çka e bënte të panevojshme administrimin e tyre sërish (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, faqe 18*).

51. Nga analiza e arsyetimit të vendimeve gjyqësore të tyre, nuk rezultojnë gabime të dukshme ligjore, që do ta bënin gjykimin të padrejtë. Për më tepër, edhe jurisprudenca kushtetuese ka pranuar se përsëritja e hetimit gjyqësor në apel, sipas nenit 427 të KPP-së, i nënshtrohet vlerësimit diskrecional të gjykatës së apelit (*shih vendimin nr. 55, datë 10.10.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, nuk mund të pranohet argumenti se vetëm mospërsëritja e hetimit gjyqësor e ka bërë shqyrtimin e çështjes të paplotë në atë masë sa të cenojë parimin e prezumimit të pafajësisë.

52. Lidhur me përcaktimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, rezulton se GJKKO-ja e Apelit ka arritur në përfundimin se kërkuesi, së bashku me persona të tjerë të organizuar në formën e grupit të strukturuar kriminal, ka kryer veprime që lidhen me transportimin, shpërndarjen dhe shitjen e lëndëve narkotike. Gjithashtu, ajo ka vlerësuar se të ardhurat e përfituara nga kjo veprimtari janë futur në qarkullimin civil përmes investimit në pasurinë e paluajtshme "University Lounge Bar" në Durrës. Për të arritur në këto përfundime, gjykata është mbështetur në rezultatet e përgjimeve telefonike dhe ambientale, vëzhgimet policore, si dhe në rezultatet e kontrollit të banesës së njërit prej të bashkëpandehurve, ku u gjet dhe u sekuestrua një sasi lënde narkotike e llojit "kokainë". Në vlerësimin e saj, këto akte përbënin një tërësi indiciesh të plota, të sakta dhe të ndërthurura, të afta për të provuar ekzistencën e fakteve penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurve.

53. Në analizë të këtyre provave, GJKKO-ja e Apelit ka evidentuar se kërkuesi dhe të bashkëpandehurit, megjithëse banonin në qytete të ndryshme, zhvillonin kontakte të shpeshta telefonike dhe takime të lidhura me sigurimin, përgatitjen dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike. Nga rezultatet e përgjimeve, gjykata ka konstatuar ekzistencën e një lidhjeje të hershme dhe të afërt ndërmjet kërkuesit dhe O. J., si dhe komunikime që lidhen me sigurimin dhe shitjen e lëndëve narkotike, përfshirë referenca ndaj shumave monetare. Gjykata ka vlerësuar se pjesëmarrësit përdornin sistematikisht gjuhë të koduar dhe të nënkuptuar, duke iu referuar lëndës narkotike me terma si "paketat e mjaltit", "copat e mjaltit", "xhini" ose "ilaçet", si dhe shkëmbenin informacion për kontrollet policore, me qëllim shmangien e zbulimit. Këto të dhëna janë konfirmuar nga rezultatet e vëzhgimeve ambientale dhe nga gjetja e lëndës narkotike në banesën e O. J. Sipas GJKKO-së së Apelit, fakti që kërkuesit nuk iu gjet lëndë narkotike në momentin e arrestimit shpjegohej nga dijenia paraprake e grupit për kontrollet policore që do të kryheshin.

54. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke theksuar se GJKKO-ja e Apelit nuk e kishte mbështetur përfundimin për fajësinë e kërkuesit në një provë të vetme. Sipas tij, të dhënat e përftuara nga përgjimet telefonike ishin ballafaquar dhe vlerësuar në harmoni me prova të tjera, si vëzhgimet ambientale dhe prova materiale e lëndës narkotike të sekuestruar në banesën e O. J. Gjykata e Lartë ka vënë në dukje se analiza e provave nuk ishte kufizuar në citimin formal të tyre, por kishte konsistuar në një vlerësim cilësor dhe të ndërsjellë të të gjitha elementeve provuese, në përputhje me kërkesat e ligjit penal material dhe procedural.

55. Në analizë të sa më sipër, nuk rezulton që GJKKO-ja e Apelit ose Gjykata e Lartë të kenë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi. Përkundrazi, ato kanë dhënë arsye të mjaftueshme për të mbështetur përfundimin se fajësia e tij ishte provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Bindja e brendshme e gjyqtarëve është formuar mbi bazën e një vlerësimi tërësor të provave dhe rrethanave të çështjes, pa cenuar garancinë kushtetuese të parashikuar nga neni 30 i Kushtetutës. Vendimi i fajësisë është mbështetur në një grup provash të tërthorta, të cilat, të vlerësuara në tërësinë e tyre, rezultojnë të plota dhe në përputhje me njëra-tjetrën në mbështetje të akuzave. Gjykatat kanë përcaktuar me qartësi faktet relevante për përgjegjësinë penale të kërkuesit dhe nuk i kanë trajtuar ato si aludime ose dyshime të thjeshta. Për rrjedhojë, deklarimi i fajësisë është bërë vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes dhe mbi bazën e provimit të fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndaj pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar.

56. Ndërsa, *sipas qëndrimit tjetër*,[3] pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë i lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar. Në rastin konkret, GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e ka deklaruar kërkuesin fajtor edhe për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe "Grupi i strukturuar kriminal". Ky përfundim është mbështetur kryesisht në përgjime telefonike, vëzhgime ambientale, takime të kërkuesit me persona të tjerë të dyshuar, komunikime të interpretuara si të koduara, si dhe sekuestrimin e një sasie prej 0.4 gramësh kokainë në banesën e shtetasit O. J. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove ose të zëvendësojë gjykatat e zakonshme në vlerësimin e provave, për sa kohë ato e mbështesin fajësinë në një tërësi provash dhe jo në një provë të vetme *(shih vendimet nr. 40, datë 22.9.2011; nr. 42, datë 18.12.2007; nr. 9, datë 28.4.2004, të Gjykatës Kushtetuese)*. Megjithatë, në rastin konkret problemi kushtetues lidhet me faktin nëse GJKKO-ja e Apelit, duke ndryshuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë mbi të njëjtën bazë provuese, ka arsyetuar në mënyrë të plotë, konkrete dhe bindëse kalimin nga pafajësia në fajësi përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

57. Në këtë këndvështrim, ndonëse GJKKO-ja e Apelit ka identifikuar disa elemente me natyrë indiciare, ajo nuk rezulton të ketë shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme sesi këto elemente, të vlerësuara në lidhje me njëra-tjetrën, e kapërcenin nivelin e dyshimit dhe provonin fajësinë e kërkuesit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Kjo merr rëndësi të veçantë në dritën e standardit kushtetues se gjykatat duhet të përcaktojnë faktet e çështjes sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime, ndërsa çdo dyshim për akuzën duhet të çmohet në favor të të pandehurit. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë, mbi të njëjtën bazë provuese, kishte arritur në përfundimin e kundërt, duke vlerësuar se nga komunikimet dhe vëzhgimet nuk përftoheshin të dhëna me rëndësi që, në harmoni me indicie të tjera, të provonin fajësinë e kërkuesit, ndërsa, pavarësisht se ai ishte përgjuar dhe vëzhguar për një kohë të gjatë, nuk ishte kontrolluar në asnjë moment në kuadër të dyshimit për shpërndarje të lëndës narkotike, ndaj tij nuk ishte sekuestruar lëndë narkotike dhe nuk ishte konstatuar ndonjë akt konkret i mbajtjes, shitjes, transportimit ose shpërndarjes së saj.

58. Në këtë kuptim, GJKKO-ja e Apelit kishte detyrimin të jepte një arsyetim të shtuar, të aftë për të shpjeguar pse vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë ishte i gabuar dhe pse provat, përfshirë edhe sekuestrimin e 0.4 gramëve kokainë në banesën e shtetasit O. J., të marra në tërësinë e tyre, justifikonin deklarimin fajtor të kërkuesit. Ky detyrim buronte jo vetëm nga standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, por edhe nga garancitë e parimit të prezumimit të pafajësisë, për sa kohë ndryshimi i vendimit të shkallës së parë solli dënimin e kërkuesit për vepra penale për të cilat ai ishte deklaruar i pafajshëm. Nga ana tjetër, ndonëse për çështjen e fajësisë së kërkuesit ekzistonin dy vendime diametralisht të kundërta të gjykatave të faktit mbi të njëjtin material provues, Gjykata e Lartë nuk e ka korrigjuar këtë mangësi të arsyetimit të GJKKO-së së Apelit, pasi, në kuadër të pretendimeve të ngritura në rekursin e kërkuesit, nuk ka ushtruar kontroll efektiv për të verifikuar nëse arsyetimi i asaj gjykate ishte i mjaftueshëm për të justifikuar deklarimin e tij fajtor sipas standardit "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm". Ajo është mjaftuar me vlerësimin se GJKKO-ja e Apelit nuk ishte mbështetur në një provë të vetme, por në të dhëna të përftuara nga përgjimet telefonike, vëzhgimet ambientale dhe sekuestrimi i lëndës narkotike në banesën e të bashkëpandehurit të gjykuar veçmas O. J., si dhe se provat ishin vlerësuar në harmoni me njëra-tjetrën, pa verifikuar në mënyrë të mjaftueshme nëse arsyetimi i GJKKO-së së Apelit ishte i aftë të justifikonte, nga pikëpamja kushtetuese, kalimin nga indiciet dhe dyshimi në provimin e fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ndërkohë, kjo mangësi në arsyetim për fajësinë e kërkuesit për veprat penale në fjalë sjell implikime edhe në drejtim të fajësisë së tij për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", për sa kohë që vetë GJKKO-ja e Apelit ka pranuar se pa ekzistencën e një vepre penale ose veprimtarie

[3] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska dhe Genti Ibrahimi.

kriminale, nuk mund të ketë produkte të saj dhe, për rrjedhojë, as pastrim të këtyre produkteve.

59. Për këto arsye, sipas këtij qëndrimi, mënyra sesi GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar për fajësinë e kërkuesit nuk përmbush standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe cenon parimin e prezumimit të pafajësisë, ndërsa Gjykata e Lartë nuk e ka korrigjuar këtë cenim. Për rrjedhojë, kërkesa e kërkuesit duhet të pranohej pjesërisht, duke u shfuqizuar vendimet e Gjykatës së Lartë dhe të GJKKO-së së Apelit dhe duke iu dërguar kësaj të fundit çështja për shqyrtim, për sa kohë shkelja e konstatuar buron nga arsyetimi i kësaj gjykate për fajësinë e kërkuesit.

60. Për sa më lart, Gjykata çmon se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa e kërkuesit konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", 133, pika 2, shkronja "i" dhe 134, pika 1, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 7.4.2026.
Shpallur më 18.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Sonila Bejtja, Asim Vokshi

VENDIM
Nr. 50, datë 21.4.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 21.4.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (D) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Dritan Gjeli, përfaqësuar nga avokati Agron Aliaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Esma Krashnica (Krasniqi), përfaqësuar nga avokatja Vojsava Agovi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1571 (186), datë 23.5.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1, i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Dritan Gjeli (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Esma Krashnicës (Krasniqi), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është trashëgimtar ligjor i babait të tij të ndjerë Sh.Gj. Ky i fundit, në vitin 1992 ka blerë nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, dega Fier, një sipërfaqe trualli prej 15 m^2 dhe me një leje ndërtimi të vitit 1991 në këtë sipërfaqe ka ndërtuar një lokal. Në vitin 1999 trashëgimlënësi i kërkuesit i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, ku ka bërë njohjen si pronar me anë të vendimit nr. 480, datë 8.4.1999, duke u regjistruar në regjistrin e pronave me notën e transkriptimit nr. 446, datë 26.4.1999.

2. Prona e trashëgimlënësit të kërkuesit është brenda sipërfaqes së fituar në bazë të vendimit nr. 152, datë 21.9.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Bashkinë e Fierit *(KKKP-ja, Fier)* nga i ndjeri M. A., të cilit i është njohur pronësia për një sipërfaqe trualli prej 400 m^2, nga të cilat, trashëgimtarët e këtij të fundit kanë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*) Fier 385 m^2. Gjatë azhurnimit në terren, për qëllim të këtij regjistrimi, ka rezultuar se një pjesë e sipërfaqes ishte e zënë dhe e regjistruar në emër të trashëgimlënësit të kërkuesit. Në këto kushte, një nga trashëgimtarët e ish-pronarit M. A., subjekti i interesuar, Esma Krashnica (Krasniqi), i është drejtuar gjykatës me kërkesë për lirimin dhe dorëzimin e truallit sipas nenit 296 të Kodit Civil.

3. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 1574, datë 8.10.2008 (*vendimi nr. 1574/2008*), ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e trashëgimlënësit të kërkuesit t'i lirojë dhe t'i dorëzojë të lirë nga çdo barrë paditëses sipërfaqen e truallit objekt konflikti gjyqësor. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim trashëgimlënësi i kërkuesit. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 7, datë 13.1.2010, duke e dërguar çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-2530 (512), datë 15.11.2012, e ka kthyer atë sërish për rigjykim në gjykatën e apelit.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, në rigjykim, me vendimin nr. 75 (60-2013-989), datë 16.10.2013, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1574/2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe rrëzimin e padisë së subjektit të interesuar. Kjo e fundit ka paraqitur rekurs ndaj këtij vendimi.

5. Referuar vendimit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 1713 rep., nr. 819 kol., datë 24.12.2021, të noteres publike, në datën 21.11.2021, ka ndërruar jetë shtetasi Sh. Gj., palë e paditur në procesin gjyqësor. Ndër trashëgimtarët ligjorë të tij është edhe kërkuesi, i biri.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1571 (186), datë 23.5.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 75 (60-2013-989), datë 16.10.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1574/2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

7. Me kërkesë të subjektit të interesuar, palë kreditore, është lëshuar urdhri i ekzekutimit, vendimi nr. 62-2024-6955 (784), datë 27.12.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Po me kërkesë të subjektit të interesuar, një përmbarues gjyqësor privat i ka dërguar trashëgimlënësit të kërkuesit, palë debitore, lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të titullit ekzekutiv, vendimin nr. 1574/2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier. Pasi është njoftuar nga kërkuesi se ai kishte ndërruar jetë, përmbaruesi ka vijuar me kalimin procedural tek trashëgimtarët e tij ligjorë, përfshirë kërkuesin.

8. Nga ana tjetër, në vitin 2015, trashëgimlënësi i kërkuesit dhe shtetasi F. Z. kanë vënë në lëvizje një proces tjetër gjyqësor të lidhur me të njëjtën pasuri, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të KKKP-së, Fier, që ka njohur pronar të ndjerin M. A., si dhe detyrimin e palës së paditur, trashëgimtarët e ish-pronarit M. A., për t'i njohur pronarë mbi sipërfaqen objekt konflikti dhe çregjistrimin e pasurisë për pjesën e mbivendosur.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2017-5862 (1635), datë 30.11.2017, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë dhe anulimin e pjesshëm të vendimit të KKKP-së, Fier, vetëm për sipërfaqen që u takon paditësve dhe detyrimin e palës së paditur për t'i njohur pronarë, si dhe çregjistrimin e kësaj sipërfaqeje toke nga ana e ZVRPP-së, Fier. Ky vendim është lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë me vendimin nr. 4347, datë 19.6.2019.

10. Në datën 16.6.2025, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), duke kundërshtuar vendimin

e Gjykatës së Lartë për lënien në fuqi të vendimit nr. 1574/2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në të cilin përcaktohej detyrimi i trashëgimlënësit të kërkuesit për të liruar dhe për të dorëzuar sipërfaqen e truallit objekt konflikti gjyqësor. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 30.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe thirrjen e subjektit të interesuar, i cili është njoftuar rregullisht. Në datën 8.9.2025, subjekti i interesuar ka paraqitur parashtrimet me shkrim, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, ndërsa në datën 8.4.2026, ka paraqitur një shtesë parashtrimesh, duke bashkëlidhur kopje të procesverbalit të datës 1.4.2026, të një përmbaruesi gjyqësor privat për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 1574/2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kopje të procesverbalit të të njëjtit përmbarues për kronologjinë e ekzekutimit të vendimit.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

11.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor,* në aspektet e mëposhtme:

11.1.1 *E drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit,* pasi Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk ka arsyetuar për disa prej prapësimeve të palës së paditur, duke i lënë ato pa përgjigje, duke përfshirë: i. përse trashëgimlënësi i kërkuesit është konsideruar posedues i paligjshëm, në një kohë që ka paraqitur prova se ishte posedues i ligjshëm i truallit me sipërfaqe 15 m^2, se ishte pajisur me autorizim për blerjen e truallit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit Fier, me leje ndërtimi të lëshuar nga ish-Komiteti Ekzekutiv i qarkut Fier dhe se ishte njohur pronar në bazë të vendimit nr. 480, datë 8.4.1999, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; ii. si ishte zhveshur në mënyrë të paligjshme subjekti i interesuar nga pronësia, kur ndërtimi nga trashëgimlënësi i kërkuesit është realizuar me leje ndërtimi të lëshuar nga institucionet përgjegjëse të asaj kohe në vitin 1991, ndërsa trashëgimlënësit të subjektit të interesuar i është kthyer prona në vitin 1995, për më tepër që nuk është mbajtur një procesverbal për dorëzimin efektiv të këtij trualli; iii. si do të lirohet trualli ndërkohë që mbi të është ndërtuar një lokal me leje, i cili është i përhershëm dhe i ligjshëm. Po kështu, nga ana e Gjykatës së Lartë nuk është arsyetuar se përse janë konfirmuar faktet e pranuara nga gjykata e shkallës së parë në raport me ato të gjykatës së apelit, duke mos evidentuar asnjë gabim ligjor në çmuarjen e provave nga kjo e fundit dhe përse nuk ka mbajtur një qëndrim për provat e reja të marra gjatë procesit në gjykatën e apelit, dhe as përse është revokuar vendimi i vitit 2014 për kalimin në seancë gjyqësore dhe në vitin 2022 është vendosur që çështja të gjykohet në dhomën e këshillimit. Ajo gjykatë nuk ka arsyetuar në mënyrë shteruese as për zbatimin dhe interpretimin e ligjit material, për situatën sesi mund të kthehet një send i pakthyeshëm kur trualli posedohet në mënyrë të ligjshme. Të gjitha këto pretendime të lëna pa përgjigje kanë cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

11.1.2 *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të njëjtat fakte të çështjes i ka vlerësuar ndryshe nga gjykatat e faktit. Ai kolegj ka vlerësuar fakte që nuk janë vlerësuar nga gjykata e apelit, duke pranuar si të sakta faktet e pranuara *apriori* nga gjykata e shkallës së parë. Kolegji Civil gjithashtu ka injoruar situatën që gjykata e apelit e ka gjykuar këtë çështje në fakt dhe ka marrë një sërë provash të reja, të cilat nuk ishin marrë dhe nënshtruar hetimit gjyqësor nga shkalla e parë. Pikërisht nxjerrja e konkluzioneve të ndryshme nga provat në raport me gjykimin në apel nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë.

11.1.3 *E drejta për t'u njoftuar e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* pasi Kolegji Civil megjithëse është vënë në dijeni nga shërbimi postar në aktin e njoftimit të zhvillimit të gjykimit në dhomën e këshillimit që trashëgimlënësi i kërkuesit kishte ndërruar jetë, nuk ka marrë masat për kryerjen e veprimit të detyrueshëm të kalimit procedural tek trashëgimtarët e tij, por ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, duke iu mohuar trashëgimtarëve të të ndjerit Sh.Gj. të drejtën për t'u njoftuar, për të paraqitur pretendime dhe fakte të reja, siç është vendimi i formës së prerë i procesit gjyqësor paralel i nisur nga trashëgimlënësi i kërkuesit për shfuqizimin e vendimit të KKKP-së, Fier dhe detyrimin për ta njohur atë pronar të sipërfaqes së mbivendosur.

11.2 *E drejta e pronës,* pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, në shkelje të parimeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, e ka zhveshur atë nga e kjo e drejtë.

12. ***Subjekti i interesuar, Esma Krashnica (Krasniqi)***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit nuk janë ngritur në nivel kushtetues, pasi nuk përmbajnë shkaqe të asaj natyre që të cenojnë liritë dhe të drejtat themelore të tij, konkretisht:

12.1 Pretendimi për cenimin e së *drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit* nuk mund të merren në shqyrtim, pasi lidhen me faktet, rrethanat, provat e çështjes, pra me zgjidhjen e çështjes në themel, që nuk është pjesë e juridiksionit kushtetues.

12.2 Pretendimi për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* nuk qëndron, pasi shqyrtimi i çështjes ka filluar në vitin 2008, duke kaluar dy herë ciklin e shqyrtimit gjyqësor në të tria shkallët e gjykimit, ku janë marrë dhe janë administruar dy herë të gjitha provat shkresore të mundshme dhe të disponueshme. Gjykata e Lartë është gjykatë ligji dhe vlerëson mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Në rastin konkret, ajo gjykatë ka vepruar brenda të gjithë kornizës ligjore në fuqi, duke marrë në analizë dhe realizuar një interpretim të drejtë të ligjit material për zgjidhjen e çështjes. Pretendimet e kërkuesit që lidhen me faktet, rrethanat dhe provat e administruara në gjykim, janë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme dhe jo të kësaj Gjykate, e cila nuk është shkallë e katërt gjykimi. Si të tilla, këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata.

12.3 Pretendimi për cenimin e së *drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit* është i pabazuar, pasi shkresa nr. 11115-00080-00-2014 prot., datë 25.4.2022, "Njoftim për zhvillim gjykimi në dhomë këshillimi", që Gjykata e Lartë i ka dërguar trashëgimlënësit të kërkuesit, ka të vendosura mbi të dy shënime kontradiktore, "Larguar" dhe "Ka ndërruar jetë", që të bën të mendosh se ky shënim i fundit nuk është bërë nga nëpunësi i postës, për më tepër që shkrimet janë të ndryshme. Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë bëhet si rregull mbi bazë të dokumenteve. Referuar nenit 482 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*) njoftimi individual i palës ndërgjyqëse ose i përfaqësuesit të saj ligjor nuk është detyrues në kuptim të ligjit në lidhje me vlefshmërinë e njoftimit. Gjykata e Lartë ka konkluduar se zgjidhja e çështjes nuk diktohet ose nuk gjendet në kushtet e zbatimit të nenit 482/a të KPC-së, për kalimin për shqyrtim të saj në seancën gjyqësore me praninë e palëve. Debati gjyqësor është zhvilluar rregullisht në gjykatat më të ulëta, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga aktet e vëna në dispozicion, Gjykata vëren se trashëgimlënësi i kërkuesit ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ndonëse gjykatat e zakonshme nuk kanë bërë kalimin procedural tek trashëgimtarët pasi ai ka ndërruar jetë, kërkuesi, duke qenë trashëgimtar i tij, ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen objekt gjykimi, për rrjedhojë legjitimohet *ratione personae*.

15. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që

pretendohet se janë cenuar. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor ku trashëgimlënësi i tij ka qenë palë e paditur. Në këtë situatë, ai nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, përveç ankimit kushtetues individual, ndaj konsiderohet i përmbushur kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

16. Për legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në këtë drejtim, duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), Gjykata ka pohuar se, në radhë të parë, i takon Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e çështjes së saj të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih vendimin nr. 69, datë 6.11.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 23.5.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 16.6.2025, pra pothuajse pas 3 vjetësh. Kërkuesi ka pretenduar se nuk i është njoftuar vendimi i Gjykatës së Lartë, ndërsa i ati i tij që ka qenë palë në proces dhe avokati që e ka përfaqësuar atë në gjykatat e faktit, kishin ndërruar jetë mbi një vit përpara se çështja të shqyrtohej në dhomën e këshillimit. Referuar dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata vëren se njoftimi për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit nr. 11115-00080-00-2014 prot., datë 25.4.2022, të Gjykatës së Lartë, drejtuar të atit të kërkuesit, është kthyer mbrapsht me shënimin "Personi ka ndërruar jetë (ka vdekur)".

18. Për sa më lart, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e GJEDNJ-së lidhur me detyrimin e Gjykatës së Lartë për njoftimin e vendimeve të saj, faktin se barra e provës në këtë drejtim nuk mund të rëndojë mbi kërkuesin në rrethanat e rastit konkret, pasi do të krijonte një barrë të tepruar ndaj tij, si dhe faktin se ai e ka paraqitur ankimin kushtetues individual një muaj pas marrjes dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se ai legjitimohet *ratione temporis*.

19. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së *drejtës për proces të rregull ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në disa aspekte (e drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit, ajo për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e drejta për t'u njoftuar e lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit), për rrjedhojë dhe të *drejtën për pronë private.*

20. Lidhur me pretendimin për cenimin e së *drejtës së pronës private*, Gjykata mban në konsideratë se argumentet e dhëna nga kërkuesi lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar prej tij dhe, për rrjedhojë, çështja do të analizohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor.

21. Pretendimet e tjera të kërkuesit bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues ndaj do të trajtohen në vijim për bazueshmërinë e tyre.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit

22. Kërkuesi ka pretenduar se ndonëse Gjykata e Lartë është vënë në dijeni që trashëgimlënësi i tij, palë e paditur në proces, kishte ndërruar jetë, nuk ka marrë masat për kalimin procedural, por ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Për rrjedhojë, kërkuesi, trashëgimtar ligjor i tij, nuk ka marrë dijeni, duke iu mohuar e drejta për të paraqitur fakte dhe argumente, siç ishte vendimi i formës së prerë i procesit gjyqësor paralel për shfuqizimin e vendimit të KKKP-së, Fier dhe detyrimin për ta njohur atë pronar të sipërfaqes së mbivendosur.

23. Subjekti i interesuar, Esma Krashnica (Krasniqi), ka prapësuar se për shkresën e paraqitur nga kërkuesi për njoftimin për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit, ka dy shënime kontradiktore, çka të bën të mendosh se njëri prej tyre nuk është bërë nga nëpunësi i postës. Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë bëhet, si rregull, mbi bazë të dokumenteve dhe se, referuar nenit 482 të KPC-së, njoftimi individual i palës ndërgjyqëse nuk është i detyrueshëm. Sipas saj, Gjykata e Lartë ka konkluduar se zgjidhja e çështjes nuk diktohet ose nuk gjendet në kushtet e zbatimit të nenit 482/a të KPC-së, për kalimin për shqyrtim të saj në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Debati gjyqësor është zhvilluar rregullisht në gjykatat më të ulëta, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit.

24. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura

nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon pashmangshmërisht në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare *(shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 37, datë 30.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. E drejta e palës për t'u njoftuar për argumentet e faktet e parashtruara në ankimin e palës tjetër është pjesë e së drejtës së individit për një proces të rregullt, nëpërmjet së cilës atij i krijohet mundësia të përgatisë mbrojtjen e vet e të parashtrojë argumentet ndaj pretendimeve të palës tjetër (*shih vendimet nr. 18, datë 4.4.2023; nr. 5, datë 26.1.2007; nr. 15, datë 13.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese)*. Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të parimit të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 28, datë 1.11.2022; nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, pretendon se nga ana e Gjykatës së Lartë nuk është kryer kalimi procedural tek trashëgimtarët e të paditurit Sh. Gj., duke i mohuar në këtë mënyrë atyre të drejtën për të paraqitur prapësime/argumente që mund të ndryshonin fatin e çështjes. Në këtë kuptim, Gjykata do të verifikojë nëse në rastin konkret është garantuar e drejta për t'u njoftuar për procesin, me pasojë cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

27. Referuar materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton se administrata e Gjykatës së Lartë ka dërguar në rrugë postare shkresën nr. 11115-00080-00-2014 prot., datë 25.4.2022, me objekt: "Njoftim për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit" drejtuar shtetasit Sh. Gj. Kjo shkresë nuk ishte arritur të dorëzohej për shkak se i padituri kishte ndërruar jetë në vitin 2021 dhe rezulton se për këtë shkresë të padorëzuar ishte lënë shënimi *"Personi ka ndërruar jetë (ka vdekur)",* fakt ky i konfirmuar edhe nga dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. 1713 rep., nr. 819 kol., datë 24.12.2021, të noteres publike, si dhe nga certifikata e vdekjes, të administruara në këtë gjykim kushtetues. Më pas, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim, në dhomën e këshillimit, shkaqet e rekursit të subjektit të interesuar Esma Krashnicës (Krasniqi), duke i gjetur të drejta ato dhe duke vendosur rrjedhimisht prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Me kërkesë të subjektit të interesuar, palë kreditore, është lëshuar urdhri i ekzekutimit dhe, po me kërkesë të saj, përmbaruesi gjyqësor privat i ka dërguar palës debitore lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të titullit ekzekutiv. Pasi është njoftuar nga kërkuesi se ai ka ndërruar jetë, përmbaruesi ka vijuar me kalimin procedural nga Sh. Gj.-ja tek trashëgimtarët e tij.

28. Për sa më sipër, Gjykata evidenton se Gjykata e Lartë ka dërguar në adresën e të atit të kërkuesit, palë e paditur në proces, njoftimin për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit, megjithatë ai njoftim nuk është realizuar, duke mos u përmbushur nga ajo gjykatë detyrimi për të njoftuar palët në proces për zhvillimin e gjykimit, në kushtet që kërkuesi dhe bashkëtrashëgimtarët e tij nuk kanë marrë dijeni për procesin që ishte duke u zhvilluar në Gjykatën e Lartë, me palë të paditur trashëgimlënësin e tyre. Vendimi i kundërshtuar i asaj gjykate nuk është një vendim mospranimi i marrë në ushtrim e sipër të veprimtarisë seleksionuese të kësaj të fundit, por nëpërmjet atij janë vlerësuar në themel shkaqet e rekursit të subjektit të interesuar, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, në favor të kësaj të fundit, dhe në disfavor të kërkuesit, që detyronte trashëgimlënësin e tij që t'i lironte dhe t'i dorëzonte të lirë nga çdo barrë sipërfaqen e truallit objekt konflikti gjyqësor subjektit të interesuar. Pavarësisht kësaj, me gjithë dijeninë për faktin se pala e paditur kishte ndërruar jetë, Gjykata e Lartë nuk ka proceduar me kalimin procedural tek trashëgimtarët e palës që ka ndërruar jetë, duke i vënë kështu në

pamundësi objektive për të marrë dijeni për procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, por edhe për të ushtruar të drejtat që u garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në këtë fazë të procesit, pra për të paraqitur përmes prapësimeve argumente në mbrojtje të interesave të tyre ligjorë e kushtetues. Edhe pse Gjykata e Lartë ka detyrimin të verifikojë, në këndvështrim të garantimit të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve, nëse administrata gjyqësore ka marrë masat për të njoftuar palët ndërgjyqëse për procesin, ajo nuk është kujdesur për kryerjen e këtij vlerësimi.

29. Duke mbajtur në konsideratë, nga njëra anë, se kërkuesi ka argumentuar sesi kjo shkelje ka pasur ndikim vendimtar në ecurinë e procesit dhe interesat e tij, pra ekzistenca e një procesi gjyqësor paralel, i cili kundërshtonte vetë titullin e pronësisë që ishte në themel të gjykimit objekt shqyrtimi dhe, nga ana tjetër, se Gjykata e Lartë ka zhvilluar një proces themeli, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, Gjykata konkludon se shkelja është thelbësore. Mosrealizimi i kalimit procedural në këtë rast ka ndikuar drejtpërdrejt në të drejtën për t'u dëgjuar, parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, por edhe në sigurinë juridike, duke marrë në konsideratë se në procesin paralel gjykatat i kanë të dhënë të drejtë trashëgimlënësit të kërkuesit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se shkeljet e konstatuara kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke e bërë atë proces të parregullt në kuptimin kushtetues, ndaj ky pretendim i kërkuesit është i bazuar.

30. Për sa është arsyetuar më sipër, Gjykata vlerëson se çështja duhet të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila duhet të kujdeset të njoftojë edhe trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Sh. Gj. për shqyrtimin e rekursit të subjektit të interesuar, duke garantuar një proces të rregullt gjyqësor në respektim të së drejtës për t'u njoftuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

31. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në zbatim të parimit të *subsidiaritetit* kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i Gjykatës së Lartë, çmon të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të kërkuesit që kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, dhe të drejtën për pronë private, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, dhe kjo e fundit duhet t'u japë përgjigje të arsyetuara këtyre pretendimeve.

32. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1571 (186), datë 23.5.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.4.2026.
Shpallur më 18.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Asim Vokshi

VENDIM
Nr. 52, datë 22.4.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare,

me sekretare Farisia Idrizaj, në datën 22.4.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 18 (S) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Sokol Lila, përfaqësuar nga avokati Andi Çuhadari, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., përfaqësuar nga avokati Ilir Johollari, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-749 (107), datë 26.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 33, 41, 42, 49, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, si dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6 e 13, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)* dhe neni 1, i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit Sokol Lila *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a. *(punëdhënësi)*, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë i punësuar si specialist në sektorin e shpronësimeve të punëdhënësit. Marrëdhënia e punës është rregulluar me kontratën individuale të datës 1.3.2010, me afat të pacaktuar, pas kalimit të periudhës 3-mujore të përcaktuar si kohë prove, dhe ka vijuar normalisht deri në datën 5.11.2013, kur kërkuesi është thirrur në takim nga punëdhënësi, pas dyshimeve për rrjedhje të informacionit konfidencial, lidhur me një tender të papërfunduar të punëdhënësit, datë kur edhe është pezulluar nga detyra. Gjatë dy takimeve të kësaj date kërkuesi, fillimisht, ka mohuar përfshirjen e tij në çështje, ndërsa, më pas, i pyetur nëse njihte njërën prej shoqërive ofertuese ose nëse ndonjë i njohur i tij kishte marrëdhënie me këtë shoqëri, ka pranuar se ka kërkuar informacion për rezultatet e tenderit për llogari të një të afërmi të tij. Në të njëjtën datë ai është njoftuar për shqyrtimin e marrëdhënies së punësimit në takimin e radhës që do të mbahej më 11.11.2013.

2. Në përfundim të takimit të datës 11.11.2013, kërkuesi është njoftuar me shkrim nga punëdhënësi se, bazuar në nenin 153 të Kodit të Punës *(KP)*, marrëdhënia e tij e punës zgjidhej në mënyrë të menjëhershme, për shkak të shkeljes së detyrimit të besnikërisë dhe ndershmërisë, sipas parashikimeve të KP-së dhe Kodit të Sjelljes. Me aktin për njoftimin e zgjidhjes së kontratës së punës, kërkuesi është njoftuar edhe se do t'i likuidohej paga për punën e bërë deri në atë datë, si dhe do të përfitonte pagën e 2 muajve punë për afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën e 15 ditëve për pushimet vjetore të pamarra.

3. Në datën 27.11.2013, punëdhënësi i ka paguar kërkuesit pagën e 7 ditëve punë e pagën për 15 ditë pushime vjetore të pamarra, në datën 24.12.2013, pagën mujore neto për muajin dhjetor, ndërsa në datën 31.1.2014, pagën mujore neto për muajin janar. Më pas, e ka pajisur atë me librezën e punës, në të cilën është pasqyruar si periudhë punësimi 1.3.2010–31.1.2014.

4. Duke mos qenë dakord me zgjidhjen e kontratës së punës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar detyrimin e punëdhënësit ta dëmshpërblejë

me: i. pagën e 1 viti punë për zgjidhjen e kontratës pa shkaqe të arsyeshme, në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustifikuar; ii. pagën e 2 muajve për vjetërsinë në punë; iii. pagën e 2 muajve për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, sipas dispozitave përkatëse të KP-së.

5. Fillimisht, padia është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pas shpalljes së moskompetencës lëndore të kësaj gjykate i është dërguar për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 7583, datë 1.7.2014, ka pranuar padinë, duke detyruar punëdhënësin t'i paguajë kërkuesit: i. dëmshpërblimin prej 12 muajsh pagë, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustifikuar të kontratës së punës; ii. dëmshpërblimin prej 2 muajsh pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së saj; iii. shpërblimin për vjetërsi në punë në masën e 1 muaji e gjysmë pagë. Po ashtu, me vendim të së njëjtës datë, gjykata ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit të saj.

6. Në lidhje me çështjen, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se zgjidhja e kontratës së punës ishte bërë nga punëdhënësi: 1. Pa shkaqe të justifikuara, pasi pyetja e kolegëve për momentin e publikimit të rezultateve të tenderit nuk ndalohej nga udhëzimi i punëdhënësit për tenderimin ose kontrata e punës. Për më tepër, edhe sipas rregullave të tenderimit të institucioneve publike, informacioni për datën e daljes së rezultatit të një tenderi nuk ka natyrë sensitive ose konfidenciale. 2. Në shkelje të procedurës, pasi e kishte zgjidhur kontratën në mënyrë të menjëhershme ditën kur kishte zhvilluar takimin, ndërkohë që duhej ta kishte bërë së paku 48 orë më pas. 3. Në shkelje të afatit të njoftimit, pasi për muajin nëntor duhej t'i kishte paguar kërkuesit pagën e plotë e jo vetëm 7 ditë pune. Më pas, pjesën tjetër të ditëve të punës të muajit duhej t'ia kishte paguar si leje vjetore, ku kjo e fundit përbënte të drejtë më vete. Kërkuesi duhej të kishte përfituar pagën e plotë për periudhën 11.11.2013–31.1.2014, pasi afati i njoftimit përfundonte në datën 11.1.2014 e, sipas nenit 143 të KP-së, zgjatej deri më 31.1.2014. Megjithatë, edhe pse parimisht i takonte dëmshpërblim për këtë shkak, në kushtet kur nuk e kishte kërkuar, kërkuesi nuk e përfitonte atë. Ndërsa pagesa e pushimeve vjetore të pamarra i duhej paguar veçmas, si shtesë mbi pagën e muajve nëntor 2013, dhjetor 2013 e janar 2014. 4. Konform nenit 145 të KP-së, kërkuesi përfitonte edhe shpërblimin për vjetërsi në punë, pasi marrëdhënia e punës kishte zgjatur mbi tre vjet. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim subjekti i interesuar.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, referuar edhe vendimit unifikues nr. 19, datë 15.11.2007 *(vendimi unifikues nr. 19/2007),* të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 971, datë 25.4.2016, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit për sa i përket detyrimit të subjektit të interesuar për t'i paguar kërkuesit pagën e 1.5 muajve punë si shpërblim për vjetërsi në punë, ndërsa e ka ndryshuar atë, duke rrëzuar padinë për pjesën tjetër.

8. Sipas gjykatës së apelit: 1. Në rastin konkret bëhej fjalë për zgjidhje normale të kontratës së punës, në respektim të afatit të njoftimit dhe procedurës. Punëdhënësi e kishte paguar kërkuesin si për periudhën e afatit të njoftimit, ashtu edhe për pushimet vjetore të pamarra. Heqja dorë e punëdhënësit nga e drejta për t'i kërkuar punëmarrësit ofrimin e punës gjatë afatit të njoftimit nuk përbën zgjidhje të menjëhershme të kontratës, ndaj disponimi i gjykatës së rrethit që dëmshpërblente kërkuesin me 12 paga mujore për këtë shkak përbënte zbatim të gabuar të ligjit, ashtu si dhe arsyetimi i saj që zgjaste edhe me 20 ditë të tjera afatin e njoftimit. Diskutimi nëse kjo zgjidhje ishte ose jo e justifikuar në kuptim të nenit 153 të KP-së, ishte i pavend, për sa kohë që KP-ja nuk ndalonte zgjidhjen e kontratës së punës nga njëra palë, me kusht që të respektohej afati i njoftimit. Kërkuesi kishte përfituar rregullisht pagesën përkatëse për periudhën e këtij afati. 2. Edhe konkluzioni i gjykatës së rrethit për mosrespektimin e procedurës përbënte interpretim të gabuar të KP-së, pasi kërkuesi ishte njoftuar me shkrim dhe ishte thirrur në takim të paktën 72 orë përpara zgjidhjes së kontratës, duke iu dhënë mundësia të shprehej. Afati prej 48 orësh i parashikuar nga kjo dispozitë ishte lejues dhe jo detyrues për punëdhënësin, në kuptimin që ai nuk ishte i detyruar të merrte vendimin për zgjidhjen e kontratës jo më parë se 48 orë nga takimi dhe nuk ndalohej ta merret këtë vendim edhe gjatë këtij afati, qoftë edhe menjëherë pas takimit të zhvilluar me punëmarrësin.

9. Me vendimin nr. 00-2025-749 (107), datë 26.2.2025, bazuar edhe në vendimin e tij njësues nr. 00-2023-5686 (724), datë 12.12.2023 *(vendimi njësues nr. 724/2023),* e nenet 485, shkronjat "b" dhe "e",

të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit për sa i takon dëmshpërblimit për mosrespektimin e procedurës *(2 muaj pagë)*, ndërsa ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit për pjesën tjetër *(1.5 muaj pagë për vjetërsinë në punë)*.

10. Sipas Kolegjit Civil: 1. Referuar librezës së punës e vërtetimit përkatës bankar, zgjidhja e kontratës nuk mund të konsiderohej e menjëhershme, pasi, në respektim të afatit të njoftimit, punëdhënësi e kishte përfunduar marrëdhënien e punës në datën 31.1.2014, duke paguar kërkuesin gjatë këtij afati. Për rrjedhojë, në këtë pjesë, disponimi i gjykatës së shkallës së parë, që i jepte kërkuesit dëmshpërblim në masën e 12 muajve punë, përbënte zbatim të gabuar të ligjit. 2. Në interpretim të shprehjes "*sipas rastit*" në nenin 143, pika 3, të KP-së, si dhe duke mbajtur në konsideratë qëndrimin njësues të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 742/2023, me "respektim të afatit të njoftimit" do të kuptohej respektimi i afatit kohor kalendarik, i cili mund të zgjatej deri në fund të muajit ose të javës vetëm në rastet kur kjo parashikohej në kontratën e punës. Ndaj, në këtë pjesë, vendimi i gjykatës së apelit, sipas së cilës afati i njoftimit nuk mund të zgjatej deri në fund të muajit nëntor, përbënte interpretim të saktë të kësaj dispozite. 3.Ashtu siç gjykata e shkallës së parë kishte arsyetuar, punëdhënësi nuk kishte marrë parasysh afatin detyrues prej 48-orësh deri në një javë pas takimit për reflektimin mbi rezultatet e takimit dhe vijimin ose jo me zgjidhjen e kontratës. Kërkuesi ishte njoftuar për zgjidhjen e kontratës së punës në të njëjtën datë kur ishte zhvilluar takimi. Ndaj, për sa i përket procedurës, arsyetimi i gjykatës së apelit, sipas të cilit ky afat nuk ishte detyrues, por lejues për punëdhënësin, nuk pasqyronte frymën e ligjit.

11. Në datën 19.6.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, i cili pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 25.6.2025. Në datën 24.9.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, ndërsa në datat 31.7.2025 dhe 20.4.2026, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës ka vendosur pranimin e kërkesave të dy gjyqtarëve kushtetues për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes dhe rrëzimin e kërkesës së një tjetër gjyqtari.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. *Kërkuesi,* në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspekt të:

12.1 *Parimit të sigurisë juridike* në drejtim të *pritshmërive të ligjshme*, pasi Gjykata e Lartë ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenet 141 e 143 të KP-së, ka keqinterpretuar vendimin e saj unifikues nr. 19/2007, e vendimin njësues nr. 724/2023, lidhur me respektimin nga punëdhënësi të afatit të njoftimit dhe pagesën formale të dëmshpërblimit, si rrjedhojë e mosrespektimit të këtij afati, në cenim edhe të *parimit të barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës. Sipas vendimit njësues, në rastin e zgjidhjes së kontratës me afat të pacaktuar nga punëdhënësi, pagesa e dëmshpërblimit që korrespondon me pagat e afatit të njoftimit nuk e zëvendëson detyrimin e punëdhënësit për të vazhduar marrëdhënien e punës deri në përfundim të këtij afati, pavarësisht së drejtës së tij për të mos e zënë me punë punëmarrësin gjatë kësaj periudhe.

12.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar nëse marrëdhënia e punës ka vazhduar gjatë periudhës nëntor 2013–janar 2014, nëse ai është lejuar të paraqitet në vendin e punës e të ushtrojë detyrat e tij gjatë kësaj periudhe dhe nëse parapagesa e dy muajve pagë është bërë nga punëdhënësi për përmbushjen në dukje të afatit të njoftimit. Arsyetimi i kësaj gjykate se punëdhënësi ka respektuar afatin e njoftimit dhe zgjidhja nuk mund të cilësohet si e menjëhershme përbën zbatim të gabuar të vendimit unifikues e vendimit njësues. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për shkaqet e lënies në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, në pjesën që kjo e fundit ka rrëzuar padinë për dëmshpërblimin me 12 muaj pagë mujore dhe ka disponuar në themel, duke cenuar pjesërisht vendimin e gjykatës së apelit dhe lënë në fuqi pjesërisht vendimin e gjykatës së rrethit.

13. *Subjekti i interesuar, shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a.*, ka prapësuar:

13.1 Pretendimet e kërkuesit për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* në drejtim të *pritshmërive të ligjshme* janë të pabazuara. Në kundërshtim nga sa ai pretendon, Gjykata e Lartë nuk ka devijuar nga interpretimet e saj njësuese e nuk ka keqzbatuar dispozitat e KP-së. Kërkuesit i janë paguar

rregullisht pagat për muajt nëntor–dhjetor 2013 e janar 2014 dhe në librezën e tij të punës është shënuar si datë e përfundimit të marrëdhënies së punës 31.1.2014, çka do të thotë se zgjidhja e kontratës nuk ka qenë me efekt të menjëhershëm, por është respektuar afati i njoftimit. Kërkuesi ka pretenduar zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës e shpërblimin e dëmit, edhe pse ka përfituar rregullisht pagën deri në përfundim të afatit të njoftimit. Po kështu, ai pretendon parapagimin formal të dy muajve pagë, ndërkohë që vërtetimi bankar tregon se ato nuk i janë parapaguar, por i kanë kaluar si pagë mujore për muajt përkatës deri në fund të afatit të njoftimit.

13.2 Pretendimet për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë të pabazuara, pasi vendimi i kundërshtuar e plotëson këtë standard. Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë të qartë, koherente e logjike për afatin e fillimit e përfundimit të marrëdhënies së punësimit dhe se realizimi i punës deri në fund të afatit të njoftimit përbën një detyrim të punëmarrësit dhe jo një të drejtë të tij. Vendimi i kësaj gjykate është i drejtë e logjik edhe në zgjidhjen e elementeve ligjore të mënyrës së llogaritjes së afatit të njoftimit dhe natyrën "detyruese" e jo "lejuese" të afatit 48-orësh nga takimi për njoftimin e zgjidhjes së kontratës së punës.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

14. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae,* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në gjykimin për të cilin janë dhënë vendimet gjyqësore, objekt kundërshtimi në Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi në ankimin kushtetues individual ka ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 26.2.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 19.6.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, si dhe *të parimit të barazisë përpara ligjit*, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 4, 142 dhe 18 të Kushtetutës. Duke pasur parasysh argumentet në themel të tyre, të cilat parashtrohen në drejtim të moszbatimit nga Gjykata e Lartë të vendimit unifikues e vendimit njësues të saj, si dhe mënyrës sesi, në mbështetje të këtyre vendimeve e dispozitave të KP-së, ajo ka disponuar për çështjen, Gjykata do t'i analizojë ato në vijim së bashku në kuadër të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike

17. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat e KP-së e ka keqinterpretuar vendimet e saj unifikues e njësues lidhur me respektimin nga punëdhënësi të afatit të njoftimit. Ajo nuk ka arsyetuar nëse marrëdhënia e punës ka vazhduar gjatë periudhës nëntor 2013–janar 2014, nëse ai është lejuar të ushtrojë detyrat e tij gjatë kësaj periudhe dhe nëse parapagesa e dy pagave mujore është bërë nga punëdhënësi për përmbushjen në dukje të afatit të njoftimit. Po sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar edhe për

shkaqet e lënies në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, në pjesën që kjo e fundit ka rrëzuar padinë për dëmshpërblimin me 12 muaj pagë, si rrjedhojë e zgjidhjes pa shkaqe të marrëdhënies së punës. Vendimi i saj është konfuz për sa i përket vlerësimit se zgjidhja e kontratës nuk është bërë me efekt të menjëhershëm dhe se është respektuar afati i njoftimit. Nga njëra anë, ajo ka referuar vendimin njësues, sipas të cilit ky afat nuk konsiderohet i respektuar nëse punëdhënësi paguan shumën korresponduese në formë dëmshpërblimi, ndërsa, nga ana tjetër, ka arsyetuar se në rastin e tij afati i njoftimit është respektuar *(Për më tepër, shih paragrafin 12.1 të këtij vendimi)*.

18. Subjekti i interesuar, shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., i ka prapësuar si të pabazuara pretendimet e kërkuesit, me argumentin se Gjykata e Lartë nuk ka keqinterpretuar dispozitat e KP-së ose vendimet e saj unifikuese e njësuese. Kërkuesi ka përfituar rregullisht pagën deri në datën 31.1.2014 të përfundimit të afatit të njoftimit, çka tregon se zgjidhja e kontratës së punës nuk është bërë me efekt të menjëhershëm. Pagat e periudhës së njoftimit nuk i kanë kaluar si dëmshpërblim, por si pagesë mujore deri në përfundimin e afatit të njoftimit. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i drejtë e logjik, si për sa i përket arsyetimit se realizimi i punës deri në fund të afatit të njoftimit përbën detyrim dhe jo të drejtë të punëmarrësit, ashtu dhe zgjidhjes së elementeve ligjore të mënyrës së llogaritjes së afatit të njoftimit dhe natyrës "detyruese" dhe jo "lejuese" të afatit 48-orësh nga takimi për njoftimin e zgjidhjes së kontratës së punës *(Për më tepër, shih paragrafët 13.1 dhe 13.2 të këtij vendimi)*.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje *(shih vendimet nr. 70, datë 15.10.2024; nr. 23, datë 4.4.2024; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*. Për sa u përket vendimeve të dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e kështillimit, Gjykata ka vlerësuar se nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 56, datë 10.10.2025; nr. 5, datë 29.1.2025; nr. 22, datë 6.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Po kështu, në funksion të garantimit të parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka theksuar se respektimi i vendimeve njësuese ose unifikuese të Gjykatës së Lartë krijon pritshmëri të ligjshme për palët lidhur me interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Përmes të tilla vendimeve, Gjykata e Lartë vendos standarde detyruese, të cilat duhen respektuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në rastet kur gjykatat nuk analizojnë çështjen konform këtyre vendimeve, ato cenojnë parimin e sigurisë juridike të kërkuesit për zbatimin e ligjit në harmoni me praktikën gjyqësore *(shih vendimet nr. 77, datë 2.12.2025; nr. 47, datë 11.6.2024; nr. 26 datë 9.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Në kuadër të parimit të sigurisë juridike, Gjykata vë në dukje se, sipas vendimit unifikues nr. 19/2007, për të pasur zgjidhje të kontratës duhet të plotësohen dy kushte dhe konkretisht: i. shprehja e vullnetit të njërës palë për zgjidhjen e kontratës; ii. respektimi i afatit të njoftimit të zgjidhjes dhe përfundimit të kontratës. Ligji ka lënë në dorë të palëve zgjidhjen e kontratës vetëm me kushtin e respektimit të afatit të njoftimit, pra palët të njoftohen përpara zgjidhjes përfundimtare të kontratës, me qëllim që të kenë mundësi të marrin masa për rregullimin e situatës së tyre personale. Gjatë afatit të njoftimit kontrata e punës është në fuqi, pavarësisht faktit që njëra palë ka bërë të ditur zgjidhjen e saj, dhe ajo përfundon me përfundimin e afatit të njoftimit. Po kështu, sipas nenit 143, pika 4, të KP-së, zgjidhja e kontratës pa respektuar afatin e njoftimit trajtohet si zgjidhje me efekt të menjëhershëm dhe gjen rregullim në nenet 153–156 të këtij kodi. Kjo zgjidhje mund të lejohet përjashtimisht për shkaqe të justifikuara, sipas nenit 153 të KP-së. Në këto raste, pala që ka zgjidhur kontratën nuk ndëshkohet, pavarësisht mosrespektimit të afatit.

22. Gjykata vëren gjithashtu se, sipas vendimit njësues nr. 724/2023, në rastin e zgjidhjes nga punëdhënësi të kontratës së punës me kohëzgjatje të pacaktuar, afati i njoftimit nuk konsiderohet i respektuar, në kuptim të neneve 141 dhe 143 të KP-së, kur punëdhënësi i paguan punëmarrësit paraprakisht, në formë dëmshpërblimi, shumën

korresponduese të pagave të këtij afati. Ky dëmshpërblim nuk zëvendëson dhe as nuk shuan detyrimin ligjor të punëdhënësit për të vijuar marrëdhënien juridike të punës me punëmarrësin deri në fund të afatit të njoftimit, pavarësisht së drejtës së tij për të mos e zënë me punë punëmarrësin gjatë kësaj periudhe, sipas nenit 129 të KP-së. Po ashtu, në rastet e zgjidhjes së njëanshme të kontratës së punës nga punëdhënësi pas përfundimit të afatit të njoftimit, kërkesat e neneve 141 e 143 të KP-së nuk mund të konsiderohen të respektuara nëse punëdhënësi, në përputhje me të drejtën për të mos e zënë me punë punëmarrësin, i parapaguan këtij të fundit totalin e pagave që i korrespondojnë afatit të njoftimit dhe njëkohësisht, duke mos pranuar shërbimet e punëmarrësit për kohën që zgjat ky afat, e konsideron të përfunduar këtë marrëdhënie pune, duke i dorëzuar punëmarrësit librezën e punës, ku pasqyrohet si datë e përfundimit të marrëdhënies së punës një datë e mëparshme nga data e përfundimit të afatit të njoftimit.

23. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, në rastin konkret Gjykata do të analizojë: nëse Gjykata e Lartë ka interpretuar e zbatuar drejt dispozitat e KP-së dhe vendimin njësues e vendimin unifikues të saj lidhur me detyrimin e punëdhënësit për respektimin e afatit të njoftimit; nëse ajo ka mbajtur në konsideratë qëndrimin e vet njësues se kur zgjidhja e kontratës do të konsiderohet e menjëhershme; nëse vendimi i saj paraqet gabime faktike ose ligjore që cenojnë standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të së drejtës së kërkuesit për t'u dëgjuar për pretendimet e ngritura në rekurs; nëse ky standard është cenuar si rrjedhojë e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit për një pjesë të pretendimeve e lënien e tij në fuqi për pjesën tjetër.

24. Në parantezë, Gjykata evidenton se KP-ja, sipas përmbajtjes në fuqi në momentin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës objekt shqyrtimi, ka parashikuar se kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar përfundon kur zgjidhet nga njëra palë dhe ka përfunduar afati i njoftimit *(neni 141)*. Në rastet kur punëmarrësi ka punuar për një periudhë 2 deri në 5 vjet, ky afat është 2 muaj *(neni 143, pika 1)* dhe mund të zgjatet, sipas rastit, deri në fund të javës ose të muajit *(neni 143, pika 3)*. Kur njëra nga palët e zgjidh kontratën pa respektuar këtë afat, zgjidhja trajtohet si me efekt të menjëhershëm *(neni 143, pika 4)*. Kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit e të bisedojë me të dhe gjatë kësaj bisede i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit duke i dhënë mundësi për t'u shprehur lidhur me to. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Kjo procedurë zbatohet edhe në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës *(neni 144, pikat 1–4)*. Megjithatë, punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara. Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, të kërkohet vazhdimi i marrëdhënies së punës *(neni 153, pikat 1 e 2)*.

25. Po kështu, KP-ja ka parashikuar pavlefshmërinë e kontratës së punës të zgjidhur pa shkaqe të arsyeshme dhe detyrimin e punëdhënësit t'i japë punëmarrësit në këtë rast një dëmshpërblim deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. *(neni 146, pika 3)*. Po sipas këtij kodi, punëdhënësi që nuk respekton procedurën e përcaktuar në nenin 144 detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim prej dy muajsh pagë, që i shtohet dëmshpërblimeve të tjera të mundshme *(neni 144, pika 5)*. Ndërsa, në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të pajustifikuar të kontratës së punës nga punëdhënësi, punëmarrësi ka të drejtën e pagës që do të kishte fituar, nëse marrëdhëniet e punës do të kishin përfunduar në fund të afatit të njoftimit të parashikuar në ligj ose me kontratë *(neni 155, pika 1)*. Në këto raste gjykata, duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos detyrimin e punëdhënësit ndaj punëmarrësit me një dëmshpërblim jo më shumë se paga e një viti pune *(neni 155, pika 3)*. Në çdo rast, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës kanë zgjatur jo më pak se tre vjet, punëmarrësi përfiton gjithashtu edhe shpërblimin për vjetërsinë në punë *(neni 145)*.

26. Në këndvështrim të sa më sipër, në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi është thirrur në takime nga punëdhënësi fillimisht për qëllime të të pyeturit lidhur me mundësinë e nxjerrjes së informacionit konfidencial, ndërsa 6 ditë më pas për shqyrtimin e marrëdhënies së punësimit, kur edhe është njoftuar me shkrim për përfundimin në mënyrë të menjëhershme të kontratës së punës, përfitimin e pagës për ditët e punës të kryera deri në

atë moment, përfitimin e pagës së 2 muajve punë në kuadër të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, si dhe pagesën e ditëve të pamarra të pushimeve vjetore. Në vijim, ai ka përfituar rregullisht pagën e 7 ditëve punë, pagën e pushimeve të pamarra, si dhe pagën e muajve dhjetor 2013 e janar 2014, ndërsa është pajisur me librezën e punës, në të cilën është pasqyruar si përfundim i marrëdhënies së punës data 31.1.2014. Duke mos qenë dakord me zgjidhjen e kontratës së punës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi ndaj punëdhënësit, duke kërkuar dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës pa shkaqe të arsyeshme, në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustifikuar, vjetërsinë në punë dhe mosrespektimin e procedurës në zgjidhjen e saj.

27. Gjykata e rrethit ka pranuar kërkesën, me arsyetimin se zgjidhja e kontratës ishte bërë në mënyrë të menjëhershme, pa shkaqe të arsyeshme e në shkelje të afatit të njoftimit dhe procedurës dhe kërkuesi përfitonte dëmshpërblim për këto shkelje, me përjashtim të dëmshpërblimit për shkeljen e afatit të njoftimit, të cilin nuk e kishte kërkuar. Sipas gjykatës, shkaqet e parashtruara nga punëdhënësi për zgjidhjen e kontratës së punës ishin të pajustifikuara, pasi nuk ishin parashikuar si të tilla në rregullat e punës së punëdhënësit. Po kështu, punëdhënësi kishte përfunduar marrëdhënien e punësimit në të njëjtën ditë që kishte thirrur kërkuesin në takim, ndërsa nuk e kishte paguar atë për periudhën e plotë të afatit të njoftimit *(shih paragrafët 5–6 të vendimit)*. Ky disponim i gjykatës së rrethit është vlerësuar në interpretim të gabuar të ligjit nga gjykata e apelit, sipas së cilës kontrata nuk ishte zgjedhur në mënyrë të menjëhershme, por në përfundim të afatit të njoftimit, gjatë të cilit kërkuesi kishte përfituar pagën e plotë, dhe fakti që punëdhënësi nuk e kishte zënë atë me punë përgjatë këtij afati, nuk përbënte zgjidhje të menjëhershme të kontratës. Po kështu, gjykata e apelit ka vlerësuar respektimin nga punëdhënësi të procedurës së njoftimit të zgjidhjes së kontratës, me argumentin se afati 48 orësh i parashikuar nga neni 144 i KP-së nuk përbënte detyrim të punëdhënësit që duhej respektuar me çdo kusht *(shih paragrafët 7–8 të vendimit)*. Ndërsa, Gjykata e Lartë ka çmuar të drejtë qëndrimin e gjykatës së apelit lidhur me respektimin nga punëdhënësi të afatit të njoftimit dhe zgjidhjen jo të menjëhershme të kontratës së punës, referuar faktit se kërkuesi ishte paguar gjatë kësaj periudhe, kurse e ka vlerësuar atë në zbatim jo të drejtë të ligjit për sa i përket respektimit nga punëdhënësi të detyrimit për njoftimin me shkrim të punëmarrësit të paktën 72 orë përpara takimit, me qëllim garantimin e së drejtës së tij për t'u dëgjuar, si dhe për njoftimin e tij me shkrim për zgjidhjen e kontratës brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit, duke lënë në fuqi në këtë pjesë vendimin e gjykatës së rrethit *(shih paragrafët 9–10 të këtij vendimi)*.

28. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka prishur pjesërisht vendimin e gjykatës së apelit dhe lënë në fuqi pjesërisht vendimin e gjykatës së rrethit për një pjesë të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs dhe lënien në fuqi të vendimit të asaj gjykate (apelit) për pjesën tjetër të pretendimeve, duke disponuar përfundimisht, në zbatim të nenit 485, shkronjat "b" dhe "e", të KPC-së, njohjen e së drejtës së kërkuesit për dëmshpërblim me 2 muaj pagë për mosrespektimin e procedurës dhe 1.5 muaj pagë për vjetërsinë në punë.

29. Nga ana tjetër, Gjykata evidenton se thelbi i pretendimeve të ngritura nga kërkuesi në rekurs lidhej me përcaktimin nëse, në këndvështrim të neneve 141 dhe 143 të KP-së, në rastin e tij marrëdhënia e punës ishte zgjidhur në mënyrë të menjëhershme apo në respektim të afatit të njoftimit. Në këtë drejtim, Gjykata vë në dukje se, ndërsa në kohën e gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit praktika gjyqësore nuk ishte elaboruar në drejtim të kushteve që duheshin mbajtur në konsideratë për qëllime të respektimit të afatit të njoftimit, në kohën e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, vendimi njësues nr. 724/2023 kishte rregulluar praktikën gjyqësore në lidhje me këtë aspekt procedural. Në çështjen në shqyrtim, pavarësisht referimit në vendimin e saj njësues, Gjykata e Lartë ka konkluduar për zgjidhjen normale të kontratës së punës, në respektim nga punëdhënësi të afatit të njoftimit, duke e mbështetur këtë në faktin se kërkuesi kishte përfituar pagesat përkatëse për periudhën nëntor 2013–janar 2014 dhe se në librezën e tij të punës ishte pasqyruar data 31.1.2014, si datë e përfundimit të marrëdhënies së punës, ndërkohë që nuk rezulton të ketë analizuar njoftimin me shkrim të punëdhënësit, të datës 11.11.2013, që zgjidhte me efekt të menjëhershëm kontratën e punës. Në këtë situatë, në vlerësimin e

Gjykatës, Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë zhvilluar një analizë të plotë të rrethanave të çështjes në përputhje me kriteret e vendosura nga praktika e saj njësuese, e detyrueshme për t'u zbatuar *(shih paragrafin 20 të vendimit)*, duke mos u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs, në cenim të së drejtës së tij për t'u dëgjuar.

30. Për sa më sipër, nisur nga natyra kushtetuese e pretendimeve të ngritura nga kërkuesi në rekurs, të cilat kanë të bëjnë me të drejtën kushtetuese për punë, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte nëse në rrethanat e çështjes konkrete, në raport me qëndrimin e saj njësues zgjidhja e kontratës së punës ishte bërë ose jo në mënyrë të menjëhershme dhe nëse pretendimi i kërkuesit se afati i njoftimit ishte respektuar vetëm formalisht nga punëdhënësi ishte ose jo i bazuar. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i *subsidiaritetit*. Respektimi i të drejtave kushtetuese, ku përfshihet edhe parimi i sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, veçanërisht i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme, pasi ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta ushtruar këtë rol aktiv, duke garantuar, në radhë të parë, respektimin e standardeve kushtetuese në procesin gjyqësor dhe duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta *(shih vendimet nr. 25, datë 5.3.2026; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese)*.

31. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme janë të bazuara, sipas arsyetimit të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-749 (107), datë 26.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 22.4.2026.
Shpallur më 18.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Sandër Beci

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë

||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË|Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 133|Datë: 24.06.2026 14:06:47 +02:00|c20bf244-6a83-4127-ba1f-82e11f01723e

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë|të një procedure automatike nga një sistem elektronik|(Qendra e Botimeve Zyrtare)